CREDINS bank

RAPORTI VJETOR
2014

01 MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

02 MESAZH NGA KËSHILLI DREJTUES

03 VEPRIMTARIA E CREDINS BANK GJATË VITIT 2014

PËRMBAJTJA

04 OBJEKTIVAT KRYESORE PËR 2015

05 ADRESAT E RRJETIT TË DEGËVE DHE AGJENCIVE TË CREDINS BANK

06 PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Maltin KORKUTI
Drejtor i Përgjithshëm

MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Të nderuar lexues,

Credins Bank njihet tashmë në treg si një bankë që konkurron ndershmërisht midis bankave me ecurinë më të mirë në vend. Pozicionimi ynë në treg pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë sjelljen dhe shërbimin ndaj klientëve. Ne flasim gjuhën tuaj nuk është thjesht një slogan marketingu, por përkufizimi i qëndrimit tonë ndaj nevojave të klientit.

Banka ka ndërtuar ndër vite një kulturë institucionale të karakterizuar nga transparenca, qeverisja e mirë e korporatës, komunikimi me klientin dhe bashkëpunimi i ngushtë mes strukturave të brendshme për arritjen e objektivave strategjike të Bankës.

Vlerat që përbëjnë themelin e kulturës institucionale janë integriteti moral, kompetenca profesionale, fokusi te klienti, angazhimi ndaj komunitetit dhe inovacioni. Për këtë arsye, kemi punuar e vazhdojmë të punojmë për të siguruar ekuilibra të përshtatshme mes përgjegjësisë dhe saktësisë së një shërbimi sa më inovativ dhe bashkëkohor pa kompromentuar në asnjë moment rendimentin, efektivitetin si dhe të qenit një kompani e përgjegjshme.

Banka është një nga aktorët kryesorë në treg, por ne besojmë se mund të bëjmë edhe më shumë. Gjatë vitit 2014 Banka ka pasur rezultate shumë të mira me fitim neto rekord prej 385 milion lekë në një mjedis me rritje ekonomike të ngadaltë. Performanca jonë në 2014 kundrejt 2013 tregon rritje pothuajse në çdo fushë të veprimtarisë sonë.

Secila nga katër linjat e biznesit, korporate, SME, mikro dhe individë ka kontribuar me përafërsi nga 5% deri në 70% të fitimeve, ku është evident kontributi i madh i segmentit të korporatës.

Megjithatë, segmenti SME është shndërruar në segmentin strategjik të bankës dhe ndër vite Banka ka kryer ndryshime organizative për t'i shërbyer këtij segmenti në mënyrë sa më efikase.

Banka ka mbështetur gjithashtu biznesin mikro që në vitin 2008 me produkte dhe shërbime, të dizenjuara për t'i shërbyer sa më mirë këtij segmenti, ka investuar vazhdimisht për të përmirësuar ekspertizën dhe njohuritë si dhe për të krijuar infrastrukturën mbështetëse. Ne ofrojmë produkte dhe shërbime për të gjithë spektrin e klientëve mikro duke përfshirë këtu edhe klientë shumë të vegjël në dimensione.

Segmenti individë ofron një numër të madh produktesh dhe shërbimesh bazë nëpërmjet një rrjeti të

gjerë degësh dhe kanalesh elektronike. Banka zotëron një pjesë të kënaqshme të tregut për segmentin e individëve dhe veçanërisht të klientëve pagamarrës.

Dëshiroj të theksoj se, Banka ka një model biznesi të qartë dhe të qëndrueshëm i cili ruan përshtatshmërinë në çdo kohë, një strukturë qeverisje në përputhje me praktikat më të mira bankare, që garanton autonominë operacionale e cila mbështetet nga një sistem kontrollesh dhe ekuilibrash të mirëpërcaktuar. Kompetencat kryesore të bankës, mundësia e saj për të përdorur aftësitë ekzistuese, janë thelbësore për ecurinë e mirë të saj.

Misioni ynë pranon si pjesë të qenësishme që njerëzit janë avantazhi ynë kryesor konkurrues. Për rrjedhojë, krijimi i ekipeve të forta dhe serioze me njerëz të talentuar ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes sonë.

Ne jemi këtu për ti garantuar klientëve, partnerëve dhe aksionarëve tanë, vazhdimësi dhe rritje të biznesit në përputhje me pritshmërinë dhe besimin e tyre.

Maltin KORKUTI
Drejtor i Përgjithshëm

MESAZH NGA KËSHILLI DREJTUES

Qeverisja efektive e korporatës në përputhje me standardet e larta ndërkombëtare është një nga prioritetet e Bankës. Gjatë viteve të fundit, vëmendja ndaj përmirësimit të praktikave të qeverisjes së korporatës ka qenë gjithnjë në rritje. Banka ka miratuar një kuadër të mirë në këtë aspekt që përfshin Këshillin Drejtues, komitetet në nivel Këshilli Drejtues dhe Drejtues Ekzekutivë. Ndërveprimi mes këtyre organeve qeverisëse ka shumë rëndësi për suksesin dhe veprimet e përditshme.

Anëtarët në përbërje të Këshillit Drejtues si dhe të Komiteteve të këtij niveli kanë njohuri, përvojë të mjaftueshme, kompetenca dhe cilësi individuale të përshtatshme për çdo aktivitet që Banka synon të ndjekë si dhe perceptim të arsyeshëm të forcave të tregut, të ekonomisë vendase, rajonale globale dhe të mjedisit rregullator dhe ligjor.

Banka ka ndërtuar një kuadër gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut në të gjithë kompaninë. Gjatë vitit 2014 janë ndërmarrë një numër iniciativash, të cilat kanë si qëllim të përmirësojnë kontrollin dhe administrimin e riskut. Këtu janë përfshirë ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësive midis punonjësve të riskut dhe shitjeve, zhvillimi i procedurave të veçanta dhe të qarta për secilin segment, si dhe zhvillimi i produktit, përmirësimet e metodologjive të klasifikimit dhe vlerësimit të riskut, vendimmarrje e shpejtë dhe fleksibël, kontrolli më i mirë i strukturave të përfshira.

Pavarësisht rolit të rëndësishëm të segmentit të korporatave në aktivitetin e biznesit dhe të ardhurat e bankës, së fundmi janë implementuar një numër iniciativash për të përmirësuar ecurinë operacionale të biznesit dhe nëpërmjet kësaj eksperiencën e klientit.

Ne shprehemi mëse optimist se Banka jo vetëm do të ruajë qendrueshmërinë në vlerat pozitive të performancës së saj, por do të rrisë konsiderueshëm pozicionimin e saj si lider. Gjejmë rastin të falenderojmë klientët, partnerët e biznesit si dhe punën e çmuar të stafit që ka arritur të përmbushë të gjitha pritshmëritë tona ndër vite.

BRETT BELCHER
Anëtar

RAIMONDA DUKA
Anëtare

MALTIN KORKUTI
Anëtar

SAJMIR SALLAKU
Kryetar i Këshillit Drejtues

MONIKA MILO
Anëtare

ELTON TORO
Anëtar

CLIVE MOODY
Anëtar

STRUKTURA ORGANIZATIVE




ASAMBLEJA E AKSIONERËVE
KËSHILLI DREJTUES
KOMITETI I KONTROLLIT
DEPARTAMENTI I AUDITIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KABINETI
DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE
DEPARTAMENTI JURIDIK
DREJTORIA M2P
SEKTORI I TRAJNIMEVE
ZV. DREJTORI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI FINANCIAR
DIVIZIONI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT
DEPARTAMENTI I KARTAVE
SEKTORI OPERACIONAL
SEKTORI AMEX DHE KARTAVE
DEPARTAMETI I LOGJISTIKËS
DREJTORIA E SIGURISË DHE MIRËMBAJTJES
SEKTORI I SIGURISË
SEKTORI I MIRËMBAJTJES
DREJTORIA E MENAXHIMIT ASETEVE
DEPARTAMENTI FINANCË KONTABILITETIT
SEKTORI I KONTABILITETIT
SEKTORI KONTROLLI FINANCIAR
SEKTORI MIS BUXHETIME
SEKTORI RARPORTIME
DEPARTAMENTI I SHITJES DHE SUPORTIT TË KREDISË (SIMA)
DREJTORIA E SHITJES DHE SUPORTIT TË KREDISË SME DHE INDIVIDË
DREJTORIA E SHITJES DHE SUPORTIT TË KREDISË AGRO DHE MIKRO
DEPARTAMENTI I BIZNESIT TËMADH
DREJTORIA KORPORATE
DREJTORIA E BIZNESIT TË MADH
DEPARTAMENTI MARKETING
SEKTORIT I ZHVILLIMIT TË SEGMENTEVE DHE PRODUKTEVE
SEKTORIT I MENAXHIMIT TË BRAND-IT DHE MARKETINGUT KOMUNIKATIV
DEPARTMENTI RRJETIT TË DEGËVE
RAJONET
DREJTORIA E SUPORTIT TË DEGËVE

BURIMET NJERËZORE

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Credins Bank është një ndër njësitë më të rëndësishme të korporatës, që kujdeset për ruajtjen e vlerave dhe parimeve kyçe të menaxhimit, zhvillimin e vazhdueshëm të stafit dhe investimin sistematik në njohuritë e tyre.

Sektori i trajnimeve brenda këtij departamenti asiston në mënyrë të vazhdueshme në transformimin e burimeve njerëzore të organizatës me qëllimin rritjen e efektivitetit dhe performacës së çdo punonjësi kundrejt objektivit final të krijimit të një ambienti profesional dhe mikpritës për klientin.
Sistemi i vlerësimit të performacës është zhvilluar dhe perfeksionuar nga viti në vit duke dhënë një kontribut thelbësor jo vetëm në vlerësimin e stafit dhe të nevojave të tyre për trajnim, por dhe në motivimin material dhe moral të tyre.

Misioni i këtij departamenti mbetet kthimi i Credins Bank në punëdhënësin më të mirë në treg, duke përthithur njerëz të talentuar, punëdashës dhe profesionalë si dhe duke ruajtur njëkohësisht nivelet optimale të kënaqësisë së çdo pjesëtari të asaj që ne nuk e quajmë thjesht korporatë, por familja Credins.

GJATË VITIT 2014 JANË ZHVILLUAR NË TOTAL 27,599 ORË TRAJNIMI



REKRUTIME DHE TRAJNIME TË PUNONJËSVE TË RINJ DHE TË PROMOVUAR

4,800 ORË TRAJNIMI PËR 40 PUNONJËS TË PROMOVUAR NË POZICIONE TË REJA



10,240 ORË TRAJNIMI PËR 64 PUNONJËS TË REKRUTUAR NGA JASHTË BANKE



NË TOTAL 15,040 ORË



SHKOLLA CREDINS

120 ORË TEORI NGA TRAJNUES TË BRENDSHËM TË BANKËS.

320 ORË PRAKTIKË NË DEGË

TOTALI: 8,800 ORË TRAJNIMI PËR 20 PJESËMARRËS

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

CMIMI
Filantropisë në rang kombëtar



CMIMI
Banka e vitit 2014

Si një ndër aktorët kryesorë në treg, ne synojmë të jemi konkurrues të suksesshëm si në aspektin financiar dhe atë social. Në këtë mënyrë ne jemi në gjendje të krijojmë vlerë jo vetëm për aksionarët dhe klientët tanë, por edhe për punonjësit dhe shoqërinë tonë në tërësi. Përgjegjësia sociale e korporatës është themeli ku bazohen vlerat tona për të bërë biznes, për të zhvilluar produkte dhe shërbime si dhe për të kontribuar në mbështetjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit dhe komunitetit tonë. Përgjegjësia sociale ka qenë dhe do të mbetet një nga prioritetet tona, duke qëndruar gjithnjë aktiv në ofrimin e shembujve të ndërgjegjësimit të biznesit për një mënyrë jetese të civilizuar.

Ne e konsiderojmë përgjegjësinë sociale të korporatës, si një element që siguron vlerë nëpërmjet vlerave si dhe shohim si thelbësore që vlerat tona të përmbushin pritshmëritë dhe standardet e grupeve tona të interesit, ndërkohë që na lejojnë ne si biznes të veprojmë me qendrueshmëri.

Credins Bank jep kontribut të vazhdueshëm në disa

EVENTI
Maratona e Jetës

MBËSHTETJE
Spitali Rajonal Vlorë

MBËSHTETJE
Spitali Rajonal Durrës

EVENTI
Matura 2014, Tiranë

shtylla kryesore. Përmendim shkurtimisht disa nga aktivitetet ku është dhënë kontribut i rëndësishëm dhe që kanë pasur impakt të konsiderueshëm social.

1. Credins Bank mbështet shëndetësinë në Shqipëri, ky ishte slogani i fushatës që Banka ndërmori për të mbështetur fushën e shëndetësisë në Shqipëri në kuadër të zhvillimit të saj. Credins Bank mbështeti financiarisht ndërtimin e laboratorit klinik dhe biokimik të Poliklinikës dhe Spitalit Rajonal Durrës, Spitali Rajonal Vlorë në pajisjen me aparatura të laboratorit të analizave, Spitalin Rajonal Shkodër në rikonstruksionin e godinës kryesore, Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi (Sanatoriumi), etj.

2. Në kuadrin e politikave për përgjegjësinë sociale, Credins Bank ka mbështetur gjithnjë projektet për energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin në energji, duke promovuar përdorimin efektiv të burimeve dhe duke zvogëluar emetimet e gazrave me efekt serë në ajër. Me mbështetjen e vazhdueshme të IFC anëtare e grupit të Bankës Botërore si dhe me mbështetjen e qeverisë Kanadeze përmes financimit dhe trajnimit mbi aspekte të rëndësishme teknike, financiare dhe ligjore, kemi rritur mundësitë për ndërtimin e një tregu të qëndrueshëm të projekteve të energjisë së rinovueshme me fokus në hidrocentrale të vogla.

3. Credins Bank mbështet fëmijët në nevojë nëpërmjet ndihmës financiare të lëvruar ndaj Fondacionit të Fëmijëve Shqiptare. Kujdesi ndaj shtresave në nevojë është një ndër shtyllat kryesore ku bazohen politikat tona në kuadrin e përgjegjësisë sociale. Credins Bank mbështet gjithashtu dhe Fshatin SOS për mbulimin e shpenzimeve të disa fëmijëve, për ti siguruar këtyre fëmijëve një shtëpi dhe një jetë të shëndetshme.

4. Në vijim të përkujdesit dhe vëmendjes së veçantë ndaj të rinjve, Credins Bank sponsorizoi eventin e zhvilluar me rastin e mbarimit të vitit akademik 2014 për maturantët e gjimnazeve të qytetit të Tiranës. Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe me mbështetjen e Credins Bank.

5. Credins Bank mbështet fushën e sportit. Këtë herë Banka ka sponsorizuar ekipin kombëtar të peshëngritjes për pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes në Kazakistan.

6. Credins Bank është angazhuar së fundmi dhe në mbështetje të artit dhe kulturës duke sponsorizuar festivalin TRA.KU fest. Ky festival promovoi vlerat dhe traditat e bukura shqiptare përmes një numri të madh aktivitetesh si konferencave akademike, festimeve tradicionale, vizitave të organizuara, koncerteve me grupet më të njohura të rajonit dhe shumë aktivitete të tjera paralele. Mbështetja në fushën e artit ka ardhur dhe në sponsorizimet e bëra ndaj Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit.

Si rrjedhojë e kontributit të spikatur në të gjitha fushat e përmendura më sipër, në Dhjetor të vitit 2014 Credins Bank fitoi edhe çmimin në rang kombëtar të filantropisë dhënë nga "Partnerët-Shqipëri", me motivacion "Për kontributin e konsiderueshëm me impakt të gjerë social që ka dhënë në fusha sensitive të shoqërisë shqiptare ku përmendim këtu shëndetësinë, arsimin dhe sigurisht promovimin e artit dhe kulturës"

Përgjatë të njëjtit vit, Banka vlerësohet gjithashtu nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë me çmimin "Banka e vitit 2014" jo vetëm për ecurinë dhe arritjet financiare, por dhe për kontributin e dhënë në ekonominë Shqiptare.

MBËSHTETJE
Spitali Rajonal Shkodër

MBËSHTETJE
Spitali Rajonal Durrës

INSTITUCIONET PUBLIKE

Marrëdhënia me Institucionet Publike ka njohur një zhvillim progresiv në kohë. Në Credins Bank është zhvilluar gjithashtu koncepti i klientit që ndërlidhet ngushtë jo vetëm në mirëqënien e tij si individ, por dhe atë të komunitetit si bashkësi e madhe individësh. Ndaj Banka i ka kushtuar vëmendje të madhe plotësimit të kërkesave të Institucioneve Publike duke mbështetur jo vetëm nevojat individuale të punonjësve, por edhe nevojat e vetë institucioneve në përmbushjen e misionit të tyre ndaj shoqërisë.

Na janë dashur disa vite pune dhe eksperience për të perfeksionuar mënyrën tonë të të punuarit, për të bërë produktin që ti ngjasojë klientit dhe jo të kundërtën. Kemi personalizuar paketën e pagave duke e plotësuar jo vetëm me produkte të domosdoshme, por dhe vlera të shtuara që lidhen me mirëqënien e klientit.

Sot numërojmë rreth 47,000 klientë buxhetorë dhe volumi i pagesave utilitare përmes shërbimit "direct debit" është rritur me 16% krahasuar me një vit më parë, sikurse është shumëfishuar numri i klientëve pagatorë, që kanë përfituar dhe përfitojnë falas sigurimin e jetës dhe shëndetit.

Kjo është shprehje e qartë besimi që vlerat tona janë në funksion të tyre.

Viti 2014 numëron
më shumë se

47,000

llogari pagamarrësish

3 *Fishohet*

numri i përdoruesve të Credins Online

2 *Fishohet*

përdorimi i shërbimeve ekstra të paketës së sigurimit të jetës dhe shëndetit

SEGMENTET TONA TË BIZNESIT

BANKINGU INDIVIDUAL

Viti 2014 shënoi përsëri rritje në disa aspekte për segmentin individë. Kjo rritje u ndje jo vetëm në shtimin e numrit të klientëve, por dhe në shtimin e kredidhënies ndaj nevojave konsumatore të këtij segmenti.

Vlen të përmendet puna e konsiderueshme e të gjithë ekipit Credins për rritjen e lehtësirave në termat e kredidhënies ndaj këtij segmenti si dhe në personalizmin e produkteve. Pjesë e risive të këtij viti ishte dhe krijimi i mundësisë së pagesës me këste me kartën e kreditit. Kjo punë u reflektua në një rritje prej 10% të portofilit të kredisë për individë.

Edhe gjatë vitit 2014, vazhdoi ofrimi falas i vlerave të shtuara dhe përfitimeve ekstra për të gjithë gamën e kartëmbajtësve dhe depozituesve të këtij segmenti, nëpëmjet binomit të suksesshëm që operon tashmë prej disa vitesh SiCRED-Credins.

Kredidhënia
u rrit me nivelin

19%

SEGMENTET TONA TË BIZNESIT

BANKINGU I BIZNESIT

Në linjë me një prej objektivave tanë strategjikë të rritjes së market share në sektorin e biznesit të madh, të mesëm dhe të vogël, vlen të theksohen treguesit pozitivë të rritjes së portofolit kredi me 19% gjatë vitit 2014.

Sektorët e synuar si energjitika, farmaceutika apo agrobiznesi u mbështetën mjaftueshëm me financime dhe kjo rezultoi me rritje të treguesve të kredidhënies krahasuar me një vit më parë dhe kryesisht segmenti SME.

Si pjesë e frymës të kthyer tashmë në traditë për të qenë sëbashku me klientët tanë në raportin vjetor, veçuam krejt rastësisht këto histori suksesi:

BANKINGU I BIZNESIT

RRJETI I BAREVE MON CHERI NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE

Flet një nga drejtuesit z. Julian Balliu

Ne erdhëm në treg ndryshe, me një frymë krejtësisht rinore dhe perëndimore. Baret dhe lokalet tona janë tejet të pëlqyera dhe të frekuentuara nga mijëra të rinj çdo ditë.

Unë do ta përkufizoja si një histori të mirëfilltë susksesi për krijimin e një marke tërësisht shqiptare dhe ngritjen e një rrjeti efiçent franchise.

Mon Cheri ka filluar aktivitetin e saj që prej vitit 2008 dhe sot numëron 13 pika të shpërndara në të gjithë qytetin e Tiranës. Cilësia e produkteve dhe shërbimi shembullor ofruar në ambiente miqësore arreduar bukur dhe me stil, janë elementë që sjellin diferencimin.

Zgjerimi i kompanisë vjen natyrshëm kur filozofia e biznesit bazohet mbi strategji konkrete me ide novatore dhe të veçanta. Në këtë udhëtim me nisma të susksesshme Credins bank bëhet partneri me të cilin gjatë vitit 2014 mundësuam hapjen e 3 pikave të reja të rrjetit Mon Cheri. Kjo marrëdhënie reciproke besimi ka nisur të japë rezultate.

coffee shop
Mon Chéri

Mon Chéri

BANKINGU I BIZNESIT

VEHIP SALKURTI, KOOP FRUT (KORPORATË NE FUSHËN E AGROBIZNESIT)

Agrobiznesi si një prej sektorëve të shumëpërfolur nevralgjikë e strategjikë të Shqipërisë, pjesë prioritare si e politikave të qeverisë ashtu edhe e projekteve ndërkombëtare, gjeti në fokus edhe në sektorin financiar. Në këtë kuadër, Credins Bank si një lojtar me peshë dhe eksperiencë në mbështetjen e këtij sektori, vijoi fuqishëm edhe gjatë vitit 2014 të financojë këtë segment, përmes produkteve dhe shërbimeve tërësisht të personalizuara sipas natyrës, sezonalitetit etj. Një nga dëshmitë e mbështetjes financiare të këtij sektori është edhe kompania Koop FRUT, me drejtues Vehip Salkurti, operative në rrethin Dibrës.

Kompania prej më shumë se 10 vite është specializuar në mbjelljen dhe prodhimin e pemëtarisë për mollë, dardhë dhe qershi. Z. Salkurti shprehet se investimi në 6.5 hektar pemëtore intensive me formën 'AKS", ka dhënë "frytet" e prodhimit vjetor prej 250 kuintal fruta aktualisht. Shtimi i kapaciteteve prodhuese përmes mbështetjes financiare nga Credins Bank, pritet të gjenerojë për tri vitet e ardhshme, pesëfishin vjetor të prodhimit me afro 1,500 kuintal fruta. Logjikisht këtij shtimi të prodhimit i shtohet edhe kapaciteti i përpunimit të frutave për prodhimin e lëngjeve natyrale, fillimisht mollë.

Ne jemi të bindur se ecuria e këtij investimi ka premisa të padiskutueshme rritje dhe suksesi për faktin e thjeshtë se jemi të "bekuar" gjeografikisht, disponojmë asete njerëzore të përkushtuara dhe që e duan këtë nismë, kemi një partner financiar të cilit i besojmë dhe na gjendet!

> "Një partner financiar të cilit i besojmë dhe na gjendet!"

BANKINGU I BIZNESIT

RUDINA GJONI, SELCA ENERGJI SHPK

Në fushën e energjisë së rinovueshme

Potenciali i burimeve ujore, mbetet për vendin tonë aset i çmuar ende i pashfrytëzuar plotësisht, ndaj edhe investimet hidroenergjitike nëse të mirëmenduara dhe mirëmanaxhuara bëhen me partenerë të besuar financiarë, premtojnë biznes të suksesshëm.

SELCA Energji u themelua si kompani në vitin 2009 dhe ka zhvilluar biznesin e saj në prodhimin e energjisë nëpërmjet hidrocentraleve.

> “Ne besuam tek burimet tona hidrike, Credins besoi në idenë tonë të gjelbërt”

Ne kemi investuar në vazhdimësi për rigjallërim të potencialit të fuqisë së vjetër hidrike të HEC-it ndërtuar mbi lumin Selca në Malësi të Madhe. Gjatë viteve të para të aktivitetit investuam në rehabilitimin e këtij hidrocentrali, i cili ishte tërësisht jo funksional.

Credins Bank na u gjend në momentet më kritike duke na mbeshtur jo vetëm në rikonstruksionin e HEC-it, por dhe në zgjerimin e kapacititetit të tij si hidrocentral. Nga energjia e gjeneruar në këtë HEC kanë përfituar të gjithë banorët e zonës me furnizim të pandërprerë me energji elektrike. Ky investim ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në rritjen e punësimit në këtë zonë. Ne besuam tek burimet tona hidrike, Credins besoi në “idenë tonë të gjelbërt” dhe së bashku energjitë tona materializohen në energji të pastër elektrike.

TREGUESIT FINANCIARË 2014

Megjithë sfidat e mëdha, situatën ende jo shumë të qëndrueshme makroekonomike, viti 2014 shënoi sërish performancë pozitive financiare për Credins Bank, tregues ky i pakundërshtueshëm i qëndrueshmërisë, konsolidimit dhe vazhdimësisë së një biznesi prej më shumë se një dekadë operativ në treg.

KAPITALI AKSIONAR (NË MILIARD LEK)

FITIMI NETO (NË MILION LEK)



TË DHËNA SASIORE BIZNESE DHE INDIVIDË

BIZNESE DHE INDIVIDË	2014	2013
Zërat e kredisë	Portofoli Bruto në '000 Lekë	Portofoli Bruto në '000 Lekë
Kreditë individë	8,423,872	7,876,671
Micro	1,565,449	2,046,341
SME	10,937,523	9,753,218
Korporatë	69,598,672	56,387,070
Total Portofoli	90,525,515	76,063,299

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË 2014

BILANCI (LEKË 000)	2014	2013
Portofoli bruto	90,525,516	76,063,299
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	(10,721,143)	(8,723,593)
Hua neto nga paradhënia	79,804,372	67,339,706
Investime në instrumenta financiarë	111,259,888	6,636,909
Totali aktiveve	130,006,264	107,610,426
Detyrime ndaj klientëve	119,831,873	91,432,733
Borxhi i varur	4,144,396	3,087,342
Totali kapitalit aksionar	10,174,391	9,810,786
Yield – portofolit	9.47%	10.42%
PASQYRAT PËRMBLEDHËSE TË TË ARDHURAVE		
Të ardhura neto nga interesat	5,252,008	4,392,460
Të ardhura neto nga aktiviteti operativ	5,659,887	4,918,504
Fitimi operativ	3,060,154	2,634,595
Humbje nga zhvlerësimi i huave (provigjione neto)	(2,452,440)	(2,271,591)
Fitimi para tatimit	607,783	363,004
Shpenzime tatime mbi fitimin	(222,641)	(89,825)
Fitimi neto i periudhës	385,142	273,179
TREGUESIT E CILËSISË SË AKTIVEVE		
Portofol me risk 30 ditë në %	16.74%	14.17%
Kreditë me probleme në %	21.86%	16.48%
Rezervat për kreditë e humbura në % / kredi me probleme	11.84%	66.26%
Rezervat për kreditë e humbura në % / kredi jo standarde	37.70%	26.05%

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR 2015

Objektivat tanë strategjikë kanë si bosht kryesor progresin e qendrueshëm dhe të matshëm në fushat e mëposhtme:

- Ruajtja dhe zgjerimi i pjesës që Banka zë në treg, sipas numrit të klientëve.
- Përmirësimi i kulturës së riskut në bankë dhe konsolidimi i administrimit të riskut dhe kontrollit.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i teknologjisë së informacionit në mënyrë që të ecë paralelisht me objektivat e rritjes së bankës.
- Krijimi dhe ruajtja i një mjedisi pune të favorshëm për të tërhequr, motivuar dhe mbajtur punonjës me cilësi të lartë, me aftësitë dhe qëndrimin e duhur.

Për arritjen e këtyre objektivave, Banka ka në fokus implementimin e një plan veprimi konkret me synim:

1. RRITJEN E EFIKASITETIT TË SHITJES

Ky objektiv do të arrihet nëpërmjet implementimit të një programi që do t'i sigurojë punonjësve mprehtësinë, mjetet, trajnimin e nevojshëm dhe stimujt që nevojiten për nxitjen e shitjeve fitimprurëse dhe me përfitim të dyanshëm për klientin dhe Bankën. Kjo nënkupton rishqyrtimin e gjithë aspekteve të njësisë së shitjeve, duke përfshirë rekrutimin, trajnimin, shpërblimin, progresin në karrierë, veprimet dhe mbështetjen për shitjet.

4.89%

TOTALI I AKTIVEVE

5.33%

DEPOZITAT E KLIENTËVE

2. RUAJTJEN DHE ZHVILLIMIN E SKEMËS SË BESNIKËRISË SË KLIENTIT

Skemat e besnikërisë së klientit përbëjnë një mënyrë efikase për të përmirësuar nivelet e ruajtjes së klientit. Kostoja e lartë e sjelljes së biznesit të ri në krahasim me mbajtjen e klientëve ekzistues është e padiskutueshme, pra rritja e nivelit të ruajtjes së klientit mund të rrisë ndjeshëm të ardhurat neto. Në këtë aspekt do të punohet akoma më fort për identifikimin e stimujve që e bëjnë një klient besnik ndaj Bankës, si dhe në analizën e preferencave të bazuar mbi të dhëna historike të raporteve që klientët kanë me Bankën.

3. SHTRIRJA DHE DIVERSIFIKIMI NË ZONAT JO URBANE

Ekonomia shqiptare po riorientohet gjithmonë e më shumë drejt sektorit të bujqësisë për shkak të potencialit të saj të madh për rritje të qendrueshme dhe mundësisë së madhe për të konkurruar në tregjet e huaja. Përmirësimet e vazhdueshme të infrastrukturës dhe kuadrit ligjor, kanë kontribuar në rritjen e vëmendjes së sektorit bankar drejt këtij sektori. Duke përfituar nga mbështetja e qeverisë dhe donatorëve, bankat tani janë më të motivuara se më parë për të krijuar avantazhe konkurruese dhe për të fituar më shumë pjesë të tregut në këtë sektor. Në këtë aspekt Banka ka në plan të rrisë ndjeshëm qasjen direkte në zonat rurale, duke u përqendruar në identifikimin e nevojave si dhe trajnimin profesional të stafit të specializuar në këtë segment.

4. NDËRTIMI I NJË SISTEMI SHPËRNDARJE GJITHËPËRFSHIRËS E MË SHUMË KANALE, ME FOKUS TË VEÇANTË TEK SISTEMI I SHËRBIMIT ONLINE.

Banka ka krijuar një rrjet mjaft të mirë degësh, i cili garanton prezencën fizike në zonat më të rëndësishme urbane të vendit dhe ka plane të qarta për rritje në zona të reja. Banka gjithashtu ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet një rrjeti të gjerë ATM-sh në të gjithë vendin dhe një platforme elektronike të konsoliduar bankare. Ne besojmë se interneti ka ndryshuar mënyrën e zhvillimit të biznesit dhe është shndërruar në një kanal të fuqishëm për marketingun dhe komunikimin e biznesit. Pavarësisht rezultateve të kënaqshme deri tani, ne e dimë se ka hapësirë të mjaftueshme për të rritur numrin e përdoruesve dhe për të transformuar këtë platformë në një kanal shumë të rëndësishëm shpërndarje. Në këtë aspekt, zgjerimi i opsioneve të shërbimit nëpërmjet këtij kanali si dhe trajtimi i çështjeve të sigurisë dhe cilësisë së informacionit, do të rrisë ndjeshëm dhe përdoruesit aktive të platformave elektronike duke zgjeruar praninë e Bankës në çdo anë të vendit.

3.56%

RRITJA E PORTOFOLIT TË KREDISË NETO

46.78%

RRITJA E FITIMIT

RRJETI I DEGËVE



RAJONET NË TIRANË DHE NUMRI I PUNONJËSVE

Rajoni 1

Tirana 1
Gjirokastër
Sarandë
Elbasan
Korçë

Tirana 2
Laprakë
Kamëz
Agjencia Emigres
Vorë

114
PUNONJËS

Rajoni 2

Tirana 3
Tirana 10
Tirana 12
Agjencia Hipotekë Tiranë
Tirana 14
Fushë Prezë

32
PUNONJËS

Rajoni 3

Tirana 5
Tirana 6
Tirana 7
Tirana 8
Tirana 9

40
PUNONJËS

Rajoni 4

Tirana 4
Tirana 11
Tirana 13
Tirana 15
Agjencia QKR
Tirana 16

44
PUNONJËS

RAJONI DURRËS



RAJONI JUG



RAJONI VERI



ADRESAT E DEGËVE

ZYRA QENDRORE	
DEGA TIRANA 1	Rruga "Ismail Qemali", Nr 4, Tiranë. Tel. (04)22 34 096, 069 20 69666, (04) 22 50 994, Fax. (04) 22 22 916, e-mail. info@bankacredins.com
DEGA TIRANA 2	Bulevardi "Zogu i I", Qendra Veve, Tiranë. Tel. (04) 22 58 252, (04) 22 57 988, Fax. (04) 22 48 654
DEGA TIRANA 3	Kryqëzimi "21-Dhjetorit", Tiranë. Tel. (04) 22 39 042, Fax. (04) 22 38 995
DEGA TIRANA 4	Rruga "Komuna e Parisit", Tiranë. Tel. (04) 23 20 234, Fax. (04) 23 20 233
DEGA TIRANA 5	Rruga "Elbasanit", pranë "Shkollës së Baletit", Tiranë. Tel/Fax. (04) 23 47 809
DEGA TIRANA 6	Brenda Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Tel (04) 23 76 305
DEGA TIRANA 7	Rruga "Ali Demi", Tiranë. Tel/Fax. (04) 23 58 083
DEGA TIRANA 8	Rruga "Bardhyl", (tek kryqëzimi i Rrugës "Bardhyl" me Rrugën "Hoxha Tahsim") Tiranë. Tel. (04) 23 47 572
DEGA TIRANA 9	Rruga "Bajram Curri", pranë kryqëzimit të "Shkollës së Bashkuar", Tiranë. Tel/Fax. (04) 23 47 560
DEGA TIRANA 10	Rruga "Ferrit Xhajko", (ish-Frigoriferi), Tiranë. Tel. (04) 22 48 485
DEGA TIRANA 11	Rruga "Gjin Bue Shpata", pranë stadiumit Selman Stermasi. Tel/ (04) 22 56 694
DEGA TIRANA 12	Pranë Shkollës "Harry Fultz", Rruga "Jordan Misja", Tiranë. Tel. (04) 22 35 439
DEGA TIRANA 13	Rruga "Myslym Shyri", Tiranë. Tel. +355 4 24 21 223, Fax. +355 4 24 21 221
DEGA TIRANA 14	Rruga "Don Bosko", Tiranë. Tel. +355 4 240 6367, Fax. +355 4 240 6368
DEGA TIRANA 15	Rruga "Luigj Gurakuqi", pranë Ushtarit të Panjohur, Tiranë. Tel: (04) 22 58 128
DEGA TIRANA 16	Bulevardi "Gjergj Fishta", Tiranë. Tel/Fax: (04) 24 19 672
DEGA LAPRAKË	Tek Blloku "Gintash" (dykatëshet) në Laprakë, Tiranë. Tel : (04) 23 56789, Fax : (04) 23 56 285
DEGA VORË	Në qendër të Vorës. Tel. (047) 26 00 435; Fax. (047) 26 00 422
DEGA KAMËZ	Në qendër të Kamzës. Tel. (04) 22 00 485; Fax. (04) 22 00 487

DEGA FUSHË - PREZË	Tek Kolaudimi i Automjeteve.
AGJENCIA 1 TIRANË	Autostrada Tiranë – Durrës, Km 11, pranë Emigres Sh.p.k. Tel. (048) 23 01 260
AGJENCIA 2 TIRANË	Agjencia tek Hipoteka e Tiranës.
AGJENCIA QKR	Pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve, Tiranë.
DEGA DURRËS 1	Bulevardi kryesor, Rruga Tregtare, Nr. 42, Durrës. Tel. (052) 236 256, (052) 239 925, Fax. (052) 239 500
DEGA DURRËS 2	Lagjja Nr.3, Rruga "Egnatia", Durrës. Tel. (052) 901 074, Fax. (052) 901 075
AGJENCIA PORTI DURRËS	Tek sheshi i trageteve në Portin detar, Durrës. Tel/Fax. (052) 234 500
AGJENCIA DURRËS 2	Pranë Qendrës Tregtare Industriale, Lagjja 17, Rr. "Unazës", Durrës. Tel/Fax. (052) 236 257
DEGA SHKOZET	Lagjja 14, Përballë Shkollës së Mesme "Olsi Lasko", Shkozet, Durrës. Tel. (052) 237 668, Fax. (052) 237 669
DEGA SHIJAK	Lagjja "Kodër", Shijak. Tel. (0571) 23 069, Fax. (0571) 23 070
DEGA KAVAJË	Lagjja Nr. 5, Kavajë. Tel. (0554) 227 858, Fax. (0554) 227 859
DEGA FUSHË - KRUJË	Lagjja "Kastrioti", Fushë - Krujë. Tel. (0563) 22 489, Fax. (0563) 22 490
DEGA FIER	Bulevardi "Jakov Xoxe". Tel. (034) 29 131, (034) 29 132, Fax. (034) 229 130
DEGA FIERI 2	Rruga Sheq i madh Fier, pranë Autogril Krasniqi, Fier, Tel. (03) 4 601 130
DEGA LEZHË	Lagjja "Besëlidhja", Rruga "Luigj Gurakuqi" Nr. 48, Lezhë. Tel. (0215) 23 500
AGJENCIA LEZHË	Pranë Hipotekës Lezhë.
DEGA VLORË 1	Lagjja "Pavarësia", Banesë 12 katëshe, Skelë, Vlorë. Tel. (033) 229 958; Fax. (033) 229 959
DEGA VLORË 2	Rruga "Demokracia", Lagjja. "Osmen Haxhiu", Vlorë. Tel. (033) 237 170
DEGA ELBASAN	Lagjja "Aqif Pasha", Rruga 28 Nëntori, (pranë Drejtorisë së Policisë). Tel. (0544) 224 213, (0544) 24 472, Fax. (0544) 24204
DEGA SHKODËR	Lagjja "Vasil Shanto", Rruga "Vaso Kadia", Shkodër. Tel. (022) 250 643, (022) 250 645, Fax. (022) 250 633
AGJENCIA SHKODËR	Sheshi "2 Prilli" tek Hipoteka.
DEGA KORÇË	Bulevardi "Republika", Lagjja 12. Tel. (082) 254 300, Fax. (082) 254 400
DEGA LUSHNJE	Bulevardi Kryesor, Ish-Hotel Myzeqeja. Tel. (022) 2986, Fax. (022) 2983
DEGA KUKËS	Lagjja Nr.2 Pallati 67, Kukës. Tel. (024) 224 903, Fax. (024) 224 904
DEGA BURREL	Lagjja "Pjeter Budi", Burrel. Tel/ Fax. (02172) 3404, Fax. (02172) 3414
DEGA BALLSH	Lagjja "5 Shkurti", Ballsh. Tel. (0313) 23642, Fax. (0313) 23643
DEGA PESHKOPI	Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi. Tel. (0128) 25624, Fax. (0218) 25625
DEGA BERAT	Lagjja "22 Tetori", Shëtitorja kryesore. Tel. (0322) 34 612, Fax. (0322) 34718
DEGA GJIROKASTËR	Rruga "18 Shtatori", Gjirokastër. Tel. (084) 266 308, (084) 266 307
DEGA SARANDË	Sheshi "Nënë Tereza", Sarandë.

PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN DERI MË 31 DHJETOR 2014

(ME RAPORTIN E AUDITUESVE TË PAVARUR)

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE 1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 2
PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT 3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE 4
1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM 5
2 POLITIKAT KONTABËL 5
2.1 BAZAT E PËRGATITJES 5
2.2 PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE 5
2.3 NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET 6
2.4 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL 10
3. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA INTERESAT 19
4. TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA TARIFAT DHE KOMISIONET 19
5. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA 19
6. SHPENZIME PERSONELI 20
7. SHPENZIME ADMINISTRATIVE 20
8. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN 20
9. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO 21
10. SHUMA TË KUSHTËZUARA ME BANKËN QENDRORE 21
11. HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE FINANCIARE 21
12. HUA DHE PARADHËNIE KLIENTËVE 21
13. LETRA ME VLERË TË VLEFSHME PER SHITJE 23
14. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE 24
15. AKTIVE JO-MATERIALE 25
16. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA 25
17. PRONA TË RIPOSEDUARA 25
18. AKTIVE TË TJERA 26
19. DETYRIMET NDAJ BANKAVE 26
20. HUATË 26
21. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE 27
22. BORXHI I VARUR 28
23. DETYRIME TË TJERA 29
24. PROVIZIONET 29
25. PRIMI I KAPITALIT 29
26. KAPITALI AKSIONAR 30
27. REZERVA E PËRGJITHSHME 30
28. ANALIZË MATURIMI PËR AKTIVET DHE DETYRIMET 31
29. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA 32
30. SHËNIME PËR PALËT E LIDHURA 33
31. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT 34
32. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR 34
32.1 NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM 34
32.2 RREZIKU I KREDISË 34
32.2 RREZIKU I KREDISË (VAZHDIM) 35
32.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT 40
32.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT (VAZHDIM) 41
32.4 RREZIKU I TREGUT 45
32.5 RREZIKU OPERACIONAL 49
32.6 MENAXHIMI I KAPITALIT 49
32.7 SHËNIME SHPJEGUESE PËR VLERËN E DREJTË 50

Building a better working world

Ernst&Young Certified Auditors
Ltd. Skopje - Tirana Branch
NUIS: K61911012I
Ibrahim Rugova Str., Sky Tower
6th Floor, 1001, Tirana, Albania

Tel: (+355 4) 24 19 575
Fax: (+355 4) 24 19 570
www.ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
PËR AKSIONARËT E BANKA CREDINS SHA

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Banka Credins SHA ("Banka") të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të Bankës më datë 31 dhjetor 2014, dhe për ecurinë financiare të saj, dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young Certified Auditors Ltd,
Skopje-Tirana Branch

Ernst Young Certified Auditors Shpk

26 qershor 2015
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Banka Credins SHA

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014[1]

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2013
		'000 Lekë	'000 Lekë
Të ardhura nga interesat	3	8,361,969	7,982,734
Shpenzime për interesat	3	(3,109,961)	(3,590,274)
Të ardhura neto nga interesat	3	**5,252,008**	**4,392,460**
Të ardhura nga komisionet	4	438,813	438,059
Shpenzime për komisionet	4	(56,734)	(99,244)
Të ardhura neto nga komisionet	4	**382,079**	**338,815**
Shpenzime të tjera, neto	5	(527,334)	(182,703)
Fitimi nga kurset e këmbimit		553,203	369,932
Të ardhura të tjera bankare		**25,869**	**187,229**
Humbje nga zhvlerësimi i huave, neto	12	(2,452,440)	(2,271,591)
Humbje nga huatë e pambledhshme	12	(135,113)	(253,589)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	15	(41,242)	(33,116)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	14	(121,313)	(125,865)
Shpenzime personeli	6	(820,992)	(773,942)
Shpenzime të përgjithshme administrative	7	(1,481,073)	(1,097,397)
		(5,052,173)	**(4,555,500)**
Fitimi para tatimit		**607,783**	**363,004**
Shpenzime tatimi mbi fitimin	8	(222,641)	(89,825)
Fitimi neto i periudhës		**385,142**	**273,179**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	13	(25,337)	5,535
Efekti i tatim fitimit		3,800	(829)
		(21,537)	**4,706**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:		***(21,537)***	***4,706***
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, pas tatim fitimit	13	**(21,537)**	**4,706**
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për pronarët, pas tatimit mbi fitimin		**363,605**	**277,885**

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Drejtues i Banka Credins Sh.A më 12Qershor 2015dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Maltin Korkuti

Drejtor i Pergjithshëm

CREDINS bank
ZYRA QENDRORE | 212-00
TIRANË –SHQIPËRI

Valentina Prodani

Drejtore e Departamentit Financë Kontabilitet

[1]Shënimet 1 deri 32 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

Banka Credins SHA

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2014[1]

	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
		'000 Lekë	'000 Lekë
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	18,531,018	18,420,806
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	10	10,318,959	8,671,294
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	11	743,189	482,594
Hua dhe paradhënie për klientët	12	79,804,372	67,339,706
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	13	15,454,143	6,636,909
Aktive afatgjata materiale	14	620,723	655,819
Aktive afatgjata jomateriale	15	131,278	162,959
Te drejta tatimore te shtyra	16	967	-
Te drejta tatimore korrente		-	53,453
Prona te riposeduara	17	3,741,694	4,398,574
Aktive të tjera	18	659,921	645,245
Totali i aktiveve		**130,006,264**	**107,467,359**
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave	18	1,832,863	1,230,864
Huatë	19	1,171,433	1,717,125
Detyrime ndaj klientëve	20	112,423,713	91,432,733
Borxhi i varur	21	4,144,396	3,087,342
Detyrime tatimore korente		65,990	-
Detyrime tatimore të shtyra	15	-	2,834
Detyrime të tjera	22	150,203	163,792
Provizione	23	43,275	21,883
Totali i detyrimeve		**119,831,873**	**97,656,573**
Kapitali			
Kapitali aksionar	25,26	5,438,330	5,438,330
Primi i aksioneve	25	1,838,990	1,838,990
Rezerva e përgjithshme	27	1,437,615	1,437,615
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	13	1,207	22,744
Fitime të pashpërndara		1,458,249	1,073,107
		10,174,391	**9,810,786**
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar		**130,006,264**	**107,467,359**

Banka Credins SHA

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014[1]

	Kapitali aksionar	Primi i lidhur me aksionin	Rezerva e përgjithshme	Rezerva rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Totali
	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë	'000 Lekë
Gjendja më 1 janar 2013	**4,742,908**	**1,290,066**	**1,314,186**	**18,038**	**1,482,405**	**8,847,603**
Fitimi i vitit	-	-	-	-	273,179	273,179
Të ardhura të tjera / (shpenzime të tjera) gjithëpërfshirëse	-	-	-	4,706	-	4,706
Total të ardhura të tjera / (shpenzime të tjera) gjithëpërfshirëse	**-**	**-**	**-**	**4,706**	**273,179**	**277,885**
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	419,287	-	123,429	-	(542,716)	-
Dividendë	-	-	-	-	(139,761)	(139,761)
Emetim i aksioneve të reja	276,135	548,924	-	-	-	825,059
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**5,438,330**	**1,838,990**	**1,437,615**	**22,744**	**1,073,107**	**9,810,786**
Fitimi i vitit	-	-	-	-	385,142	385,142
Të ardhura të tjera / (shpenzime të tjera) gjithëpërfshirëse	-	-	-	(21,537)	-	(21,537)
Total të ardhura të tjera / (shpenzime të tjera) gjithëpërfshirëse	**-**	**-**	**-**	**(21,537)**	**385,142**	**363,605**
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**5,438,330**	**1,838,990**	**1,437,615**	**1,207**	**1,458,249**	**10,174,391**

[1] Shënimet 1 deri 32 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014[1]

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2013
		'000 Lekë	'000 Lekë
Aktivitetet operative			
Fitimi i periudhës		385,142	273,179
Rregullimet për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	14,15	162,555	158,981
Aktivet afatgjata të nxjerra jashtë përdorimi	14,15	6,155	7,933
Zhvlerësimi i huave ndaj klientëve	12	2,452,440	2,271,591
Humbje të tjera nga huatë e pambledhshme	12	(752,169)	(253,589)
Zhvlerësimi i pronave të riposeduara	17	462,224	192,179
Të ardhurat neto nga interesat	3	(5,252,008)	(4,392,460)
Shpenzime tatim fitimi	8	222,641	89,825
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur	21	(29,163)	(1,816)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave		(269,851)	333,143
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve		(13,520,663)	(7,646,118)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën e Shqipërisë	10	(1,647,904)	(1,538,597)
Ndryshimi në pronat e riposeduara		194,657	25,280
Ndryshimi në aktive të tjera	18	(14,676)	(385,732)
Ndryshim në detyrimet ndaj bankave	19	603,032	(207,396)
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve	21	20,799,162	13,533,139
Ndryshimi në detyrime të tjera	23,24	11,600	(758,800)
Interesi i arkëtuar		7,645,462	7,607,051
Interesi i paguar		(3,322,863)	(3,390,731)
Tatim fitimi i paguar		(106,999)	(127,881)
Flukset monetare neto në aktivitetet operative		**8,028,775**	**5,789,181**
Aktivitetet investuese			
Blerje e letrave me vlerë		(22,903,317)	(10,240,943)
Shitje e letrave me vlerë		300,000	17,965
Letra me vlerë të maturuara		13,842,473	8,194,787
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	14	(91,751)	(56,540)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	15	(10,184)	(102,089)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		**(8,862,779)**	**(2,186,820)**
Aktivitetet financuese			
Flukse hyrëse nga borxhi i varur	22	1,154,227	400,852
Flukse dalëse të borxhit të varur		(420,600)	-
Flukse hyrëse nga financime të reja		-	1,182,782
Pagesa të financimeve të reja	20	(182,188)	(330,401)
Flukse hyrëse nga parapagimi i kapitalit të nënshkruar të paregjistruar		392,777	-
Emetim i kapitalit		-	829,765
Dividentë të paguar		-	(139,761)
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese		**944,216**	**2,604,039**
Rritje në aktive monetare dhe ekuivalente me to		**110,212**	**6,206,400**
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 1 Janar		**18,420,806**	**12,214,406**
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor		**18,531,018**	**18,420,806**

[1] Shënimet 1 deri 32 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

1 Informacion i Përgjithshëm

Banka Credins SHA (këtej e tutje "Banka") është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 1 Prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 Mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në Dhjetor 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë" (këtej e tutje referuar si "Banka Qendrore").

Me 31 Dhjetor 2014, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme të saj në Tiranë, 44 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shijak, Shkozet, Kavajë, Lushnje, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe Peshkopi si dhe 5 agjencive në Tiranë, Shkodër dhe Durrës (31 Dhjetor 2013: 41 degë dhe 5 agjenci).

Më 31 Dhjetor 2014 Banka kishte 654 punonjës (31 Dhjetor 2013: 619 punonjës).
Adresa e zyrave qendrore të bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rr. Ismail Qemali Nr. 21, Tiranë, Shqipëri.

2 Politikat Kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të investuara dhe aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të matura me vlerë të drejtë.

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(i) Deklarata e përputhshmërisë
Pasqyrat financiare të bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare
Banka e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e pasqyrave financiare (jo korrente) paraqitet në shënimin 28.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Bankës.

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël te Bankës, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(I) Parimi i vijimësisë
Banka kryen rregullisht "stress test-e", për të testuar impaktin e mundshëm të indikatorëve makroekonomikë në pozicionin financiar, performancën dhe përputhshmërinë rregullatore. Këto "stress test-e" janë fokusuar kryesisht në impaktin që disa skenarë makro dhe mikroekonomikë mund të kenë në portofolin e kredisë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave të Bankës, pozicionit financiar duke përfshirë rrezikun e tregut. Gjatë këtij testimi përdoren modele zyrtare parashikuese të Bankës së Shqipërisë dhe vlerësime të brendshme të Bankës. Testet janë dinamike dhe kryhen për të vlerësuar efektin e mundshëm te ndikimit të panikut të klientit tek zërat e ndryshëm të bilancit, të ardhurave dhe shpenzimeve, për një periudhë të caktuar kohore. Drejtimi i bankës ka kryer një vlerësim të aftësisë së bankës për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që banka ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(II) Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve
Banka rishikon portofolet e saj të kredisë në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Banka bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vrojtueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol kredish para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në këtë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrojtueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një bankë, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e huave nga huamarrësit.

(III) Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje
Banka shqyrton letrat e saj të borxhit të klasifikuara si investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhënieve.

Banka regjistron humbje nga zhvlerësimi i instrumentave të kapitalit të vlefshme për shitje kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë të tyre nën koston e tyre. Përcaktimi i asaj që është "i rëndësishëm" apo "i zgjatur" kërkon gjykim. Në marrjen e këtij vendimi, Banka vlerëson, përveç faktorëve të tjerë, lëvizjet historike në çmimin e aksionit dhe kohëzgjatjen, si dhe masën në të cilën vlera e drejtë e një investim është më e ulët se kostoja e tij.

2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.
Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Bankës.

Banka ka adoptuar të gjithë standardet dhe interpretimet e reja dhe të rishkikuara të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Komiteti i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Interpretimeve (KIRFN) të cilat janë të aplikueshme për aktivitetet e saj.

Standardet e mëposhtme, amendimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese janë të detyrueshme për periudhat kontabël të Bankës që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014.

Standardet dhe amendamentet e meposhtme te SNRF hyn ne fuqi ne date 1 Janar 2014:

- **SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja (Ndryshuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare**
  Këto ndryshime sqarojnë kuptimin "aktualisht ka një të drejtë të zbatueshme ligjore për kompensim". Ndryshimet sqarojnë gjithashtu zbatimin e SNK 32 Kriteret e Kompensimit për Sistemet e Shlyerjes (si për shembull sistemet e institucioneve qendrore të kleringut), të cilët zbatojnë mekanizma të shlyerjes bruto, të cilat nuk janë të njëpasnjëshme. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk ka asnjë ndikim në politikat e Bankës.
- **SNK 39 Instrumentat Financiarë (Ndryshuar): Njohja dhe Matja - Zëvendësimi i Derivativeve dhe Vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtës**
  Banka nuk ka instrumente derivativë dhe ky ndryshim nuk ka asnjë ndikim mbi të.
- **SNK 36 Zhvlerësimi Aktiveve (Ndryshuar) – Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Shumat e Rikuperueshme të Aktiveve Jo – Financiare**
  Këto ndryshime eleminojnë pasojat e paqëllimshme të SNRF 13 mbi dhënien e informacioneve shpjeguese që kërkohen sipas SNK 36. Përveç kësaj, këto ndryshime kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të shumave të rikuperueshme për aktivet apo Njësitë Gjeneruese të Parasë, për të cilën zhvlerësimi është njohur apo është rimarrë gjatë periudhës. Nuk ka asnjë efekt në pasqyrat financiare të Bankës nga aplikimi i ndryshimeve të mësipërme.
- **KIRFN Interpretimi 21: Tarifat**
  Banka nuk ndonjë tarife të vendosur dhe si pasojë interpretimi i ri nuk ka asnjë ndikim mbi Bankën.
- **SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshuar)**
  Si rrjedhoje e standardeve të reja SNRF 11 Sipërmarrje të Përbashkëta dhe SNRF 12 Deklarimin e Interesave në Entietetet e Tjera, SNK 28 Investime në Pjesëmarrje është riemërtuar si SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta, dhe përshkruan aplikimin e metodës së kapitalit ndaj pjesëmarrjeve të përbashkëta përveç investimeve në pjesëmarrje. Ky ndryshim nuk ka patur ndonjë efekt në politikat e Bankës.

2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

- **SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, SNK 27 Pasqyrat Financiare të Veçanta**
  SNRF 10 zëvendëson atë pjesë të SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta që adreson kontabilizimin për pasqyrat financiare të konsoliduara. Gjithashtu adreson çështje të ndritura nga KIS-12 Konsolidimi — Entitetet me Qëllim të Veçantë. SNRF 10 përcakton një model kontrolli të vetëm që aplikohet nga të gjitha entitetet, përfshi dhe ato me qëllim të veçantë. Ndryshimet e prezantuara nga SNRF 10 do kërkojnë që Drejtimi të ushtrojë gjykime të rëndësishme për të përcaktuar se cilat entitete janë të kontrolluara dhe si rrjedhojë janë të detyruara të konsolidohen me shoqërinë mëmë, në krahasim me kërkesat fillestare të SNK 27. Aplikimi i këtij standardi të ri nuk ka ndikim në raportimet e Bankës.

- **SNRF 11 Sipërmarrjet e Përbashkëta**
  SNRF 11 zëvendëson KIS-13 Entitetet me Kontroll të Përbashkët – Kontributet jo-monetare të Përbashkëta. SNRF 11 eliminon opsionin për të kontabilizuar entitetet me kontroll të përbashkët duke përdorur konsolidimin e pjesshëm. Në vend të këtij opsioni, Entitetet me Kontroll të Përbashkët që përmbushin përkufizimin e Sipërmarrjeve të përbashkëta duhet të kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit. Aplikimi i këtij standardi të ri nuk ka ndikim në raportimet e Bankës.

- **SNRF 12 Deklarimi i Interesave në Entitetet e Tjera**
  SNRF 12 përfshin të gjithë deklarimet që më parë përmnendeshin tek SNK 27 në lidhje me konsolidimin e pasqyrave financiare, si dhe tek SNK 31 dhe SNK 28. Këto deklarime lidhen me interesat e një entiteti në filiale, marrëveshje të përbashkëta, pjesëmarrje apo entitete të strukturuara. Një numër deklaratash të reja nevojiten gjithashtu. Këto deklarime të reja nuk kanë ndikime në raportimet e Bankës.

Deklaratat e reja kontabël

Janë publikuar disa standarde dhe interpretime të rejate cilat jane të detyrueshme për periudhatfinanciare që fillojnë më 1 Janar 2015 ose më pas. Banka nuk i ka adoptuar keto standard perpara se ato te hynin ne fuqi. Standardet dhe amendimet që nuk janë të aplikueshme për Bankën nuk janë diskutuar.

- **SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivet Afatgjata jo-Materiale (Ndryshimi): Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit**

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2016. Ky ndryshim sqaron parimin e SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivet Afatgjata jo Materiale, ku të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të gjeneruara nga veprimtaria e një biznesi (ku aktivi bën pjesë) në vend të përfitimeve ekonomike që konsumohen përmes përdorimit të aktivit. Si rezultat, raporti i të ardhurave i krijuar mbi të ardhurat e përgjithshme të pritshme për tu gjeneruar nuk mund të përdoren për të zhvlerësuar aktivet afatgjata material, por mund të përdoren vetëm në raste shumë të rralla për të amortizuar aktivet afatgjata jo materiale. Banka nuk përdor aktualisht raportin e specifikuar të të ardhuarve për qellime të amortizimit dhe drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (Ndryshuar): Kontributet e Punonjësve**

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014. Ndryshimi aplikohet për kontributet nga punonjësit apo palët e treta për plane përfitimesh te percaktuara. Aktualisht Banka nuk siguron ndonjë plan për punonjësit dhe ky ndryshim nuk do të ketë ndikim mbi të.

- **SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja**

Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershem. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Drejtimi është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi dhe nëse ky standard do të aplikohet më herët.

- **SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (Ndryshimi): Kontabiliteti i Marrjes së Interesave në Operacione të Përbashkëta:** Shoqeria nuk ka asnjë marrëveshje të përbashkët.

- **SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë transaksione të veprimtarise të zakonshme të njesise ekonomike (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata material dhe jo-materiale). Dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshi ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në llogaritjen e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe vlerësimet. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin që standardi do të ketë, megjithatë nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm meqenëse shoqëria është institucion financiar.

2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)
Deklaratat e reja kontabël (vazhdim)

- **SNK 27 Pasqyrat Financiare te Veçanta (Ndryshuar)**

Ndryshimi bëhet efektiv nga data 1 janar 2016. Ky ndryshim do të lejojë entitetet të përdorin metodën e kapitalit për të llogaritur investimet në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe investime ne pjesmarrje në pasqyrat e tyre financiare individuale, si dhe do të ndihmojë disa juridiksione të lëvizin drejt SNRF, për pasqyrat financiare individuale, duke ulur kostot e përputhshmërisë pa zvogëluar informacion e disponueshëm për investitorët. Banka nuk ka investime në njësi ekonomike të tjera dhe amendimi nuk do të ketë ndikim mbi Bankën.

- **Ndryshimi në IFRS 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta: Shitja apo Kontributi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe Bashkëpunëtorit apo Sipërmarrjes së tij të Përbashkët**

Keto amendime hyjnë në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Banka aktualisht nuk ka investime në njësi ekonomike të tjera, nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe ndryshimi nuk do të ketë ndikim mbi Bankën, deri në dhjetor 2015.

Përmirësimet Vjetore

BSNK ka publikuar **Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Ciklit 2010 – 2012**, që është një permbledhje e ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014.

- ***SNRF 2 Pagesat e Bazuara në Aksione:*** Ky përmirësim ndryshon përkufizimet e "kushtit te perfitimit te aksioneve' dhe "kushtet e tregut" dhe shton përkufizimet për "kushtet e performancës", dhe "kushtet e shërbimit" (të cilat ishin më parë pjesë e përkufizimit të 'kushtit të perfitimit të aksioneve'). Ky amendim është efektiv në prospektivë.
- ***SNRF 3 Kombinimet e Biznesit:*** Ky përmirësim sqaron rrethanat e kushtëzuara në një blerje biznesi, që nuk është klasifikuar si kapital, e që më vonë mbahet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, edhe nëse nuk është objekt i SNRF 9 Instrumentat Financiarë. Ky amendim është efektiv për kombinimet e binznesit në prospektivë.
- ***SNRF 8 Segmentet e Shfrytëzimit:*** Ky përmirësim kërkon që njësia ekonomike të japë informacione shpjeguese mbi gjykimet e bëra nga drejtimi, në zbatimin e kritereve të specifikuara në segmentet e shfrytëzimit dhe sqaron se njësia ekonomike duhet vetëm të kryejë rakordime të totalit të aktiveve të segmenteve raportuese me totalin e aktiveve të njësisë ekonomike, nëse aktivet e segmenteve raportohen rregullisht. Ky amendim është efektiv në retrospective.
- ***SNRF 13 Matja me Vlerën e Drejtë:*** Ky përmirësim në bazë të konkuzioneve të xjerra për SNRF 13 sqaron se publikimi i SNRF 13 dhe ndryshimi i SNRF 9 dhe SNK 39 nuk e ka hequr mundësinë për të matur të drejtat dhe detyrimet afatshkurtra me normë interesi te deklaruar në faturat e tyre, pa skontuar nëse efekti i skontimit nuk është material.
- ***SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale:*** Ndryshimi sqaron se kur një zë i aktiveve afatgjata materiale rivlerësohet, vlera kontabël bruto përshtatet në një mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me rivlerësimin e vlerës kontabël. Shoqeria nuk përdor modelin e rivlerësimit sipas SNK 16.
- ***SNK 24 Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura:*** Ndryshimi sqaron se një entitet që i siguron shërbime personeli drejtues njësisë raportues ose shoqërisë mëmë të njësisë raportues është palë e lidhur me njesinë raportuese. Sqarimi mund të përfshijë këto entitet në palët e lidhura të Bankes.
- ***SNK 38 Aktivet Jo-materiale:*** Ndryshimi sqaron se kur rivlerësohet një aktiv afatgjate jo-material, vlera kontabël bruto korrigjohet në një mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me rivlerësimin e vlerës kontabël. Banka nuk përdor modelin e rivlerësimit për aktivet afatgjata materiale.

BSNK ka publikuar Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Ciklit 2011 – 2013, që është një përmbledhëse e ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014.

- ***SNRF 3 Kombinimet e Biznesit:*** Banka nuk ka ndonjë kombinim biznesi që është në vazhdimësi ose të planifikuar.
- ***SNRF 13 Matja me Vlerën e Drejtë:*** Ky përmirësim sqaron se qëllimi i përjashtimit të portofolit të përcaktuar në paragrafin 52 të SNRF 13 përfshin të gjitha kontratat e llogaritura brenda objektit të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja ose SNRF 9 Instrumentet Financiare, pa marrë parasysh nëse ata plotësojnë përkufizimin e aktiveve financiare ose detyrimeve financiare, siç përcaktohet në SNK 32 Instrumentet Financiare: Paraqitja. Banka aktualisht nuk ka portofol të aktiveve dhe detyrimeve që menaxhohet sipas bazës së ekpozimit neto, sic përcaktohet ne SNRF 13, pra ky sqarim nuk ka ndikim mbi Shoqerine.
- ***SNK 40 Aktive Afatgjata Materiale te Investuara:*** Banka nuk është e angazhuar në ndonjë kombinim biznesi që mund të plotësojë përkufizimin e aktiveve afatgjata të investuara.

2.3 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)
Përmirësimet Vjetore (vazhdim)

BSNK ka publikuar Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Cikli 2012 – 2014, që është një përmbledhje e ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016.

- ***SNRF 5 Aktive Afatgjata qe mbahen për tu Shitur dhe Operacionet Jo-të Vijueshme:*** Ndryshimi sqaron se ndryshimi nga një prej metodave te shitjes tek tjetra (përmes shitjes apo përmes shpërndarjes tek pronarët) nuk duhet të konsiderohet si një plan i ri shitjeje, por si një vazhdim i planit origjinal. Prandaj nuk ka ndërprerje të zbatimit të kërkesave në SNRF 5. Amendimi gjithashtu sqaron se ndryshimi i metodës së shitjes nuk ndryshon datën e klasifikimit.
- ***SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese:*** Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv. Gjithashtu, ndryshimi sqaron se SNRF 7 jep informacionet shpjeguese lidhur me kompensimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare se nuk janë të nevojshme në pasqyrat financiare te ndermjetme.
- ***SNK 19 Përfitimet e Punonjësve***: Ndryshimi sqaron se "thellësia" e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se sa vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të gjerë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, duhet të përdoret raporti i bonove qeveritare.
- ***SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm:*** Banka nuk raporton pasqyra financiare të ndërmjetme me qëllim të përgjithshëm.
- ***SNRF 10, 12 dhe SNK 28: Njesite e investimit: Aplikimi i Perjashtimit te Konsolidimit (Amendimet)*** Amendimet sqarojne tre ceshtje qe lindin ne praktike gjate aplikimit te perjashtimit te konsolidimit te njesive te investimit. Banka nuk e permbush percaktimin e njesive te investimiet dhe amendimet nuk jane te aplikueshme.
- ***SNK 1: Iniciativa e dhenies se informacioneve shpjeguese (Amendimet)*** Ndryshimet në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* inkurajojnë shoqerite për të aplikuar gjykimin profesional në përcaktimin e informacionit për tu paraqitur në pasqyrat financiare si shënime shpjeguese dhe si t'a strukturojne atë në pasqyrat e tyre financiare. Ndryshimet behen efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2016. Ndryshimet në SNK-të më shumë sqarojne sesa ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese te SNK 1. Ndryshimet kanë të bëjnë me materialitetin, radhen e shënimeve, nentotalet dhe ndarjen, politikat kontabël dhe paraqitjen e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse që rrjedhin nga kontabilizimi i investimeve në kapital. Drejtimi është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi duke qënë se ai tenton të përmirësojë paraqitjen dhe rëndësine e informacionit në pasqyra financiare.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

(1) Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Bankës, janë njohur duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet jo monetare dhe detyrimet maten në kosto historike të monedhave të huaja dhe këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lek ndaj një njësie të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	31 /12/ 2014	31 /12/ 2013
USD	115.23	101.86
EUR	140.14	140.20
GBP	179.48	168.39
CHF	116.52	114.41
CAD	99.55	95.70
XAU	4,444.28	3,993.71

(2) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

(i) Data e njohjes
Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

(ii) Matja fillestare e instrumentave financiarë
Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuara dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (përfshirë aktivet dhe detyrimet që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

(iii) Klasifikimi i aktiveve financiare
Aktivet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalente
- Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat
- Investimet e letrave me vlerë

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

(iv) Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital
Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga Banka janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit
Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Bankës pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Banka janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)
(2) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

(v) Hua dhe paradhënie klientëve dhe bankave
Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv, dhe që Banka nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që banka ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që banka gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që banka, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Kur Banka është qiradhënës në një marrëveshje qiraje që transferon te qiramarrësit të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësisë e një aktivi, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënieve. Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një pasuri tërësisht e ngjashme) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("repo e anasjelltë ose huamarrje letrash me vlerë"), marrëveshja është kontabilizuar si marrëveshje e anasjelltë riblerjeje (letra me vlerë kolateralizuara) dhe aktivet e lidhura me to nuk njihen në pasqyrat financiare të Bankës. Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhënieve për klientët dhe bankat janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

(vi) Letrat me vlerë të investimit
Letrat me vlerë të investimit kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, ose si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(a) Instrumenta financiarë të mbajtur deri në maturim
Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë dizenjuar me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të vlefshme për shitje. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Nëse banka do të shesë ose riklasifikojë para maturimit një shumë të rëndësishme të letrave me vlerë te mbajtura deri në maturim (përveçse në rrethana të caktuara specifike), e tërë kategoria do të "njollosej" dhe do të duhej të riklasifikohej si e vlefshme për shitje. Për më tepër, banka do ta kishte te ndaluar klasifikimin e ndonjë aktiv financiar si të mbajtur deri në maturim gjatë dy viteve në vijim.

(b) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje
Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk dizenjohen si një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuara, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbarten me kosto. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

(vii) Borxhi i emetuar dhe fonde të tjera të marra borxh
Instrumentat financiarë të emetuara nga banka, që nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë klasifikuar si "borxhi i varur", ku substanca e marrëveshjes kontraktuale rezulton në atë që banka ka një detyrim për t'i shlyer mbajtësit, nëpërmjet mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, ose të përmbushë detyrimin nëpërmjet një mënyre tjetër përveçse duke këmbyer një shume te caktuar parash ose aktive te tjera financiare për një numër fiks aksionesh në kapitalin e vet.

Pas matjes fillestare, borxhi i emetuar dhe huamarrjet e tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Një analizë e borxhit të emetuar të bankës është paraqitur në Shënimin 22.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(3) Mosnjohja (çregjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

(i) Aktivet financiare
Banka nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjistron) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen te një njësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes ne aktivet financiare te transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si nje aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilëve transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose një pjese të rreziqeve ose shpërblimeve të aktiveve të transferuara. Në rast se Banka mbart të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi "swap" për aktivet e transferuara, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financimi i sigurt i njëjtë me transaksionet e riblerjes. Për transaksionet ku Banka as nuk mban dhe as nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh (çregjistron) aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në ato transferime ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin për aq kohë sa ky aktiv rezulton i përfshirë, gjë e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar. Në transaksione të caktuara Banka mban të drejtat e shërbimit ndaj një aktivi financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e mosnjohjes.

(ii) Detyrimet financiare
Banka çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë
Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, te mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundur, Banka e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuara të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuara janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktual që kryhen në mënyrë të rregullt dhe ne kushte te barabarta. Një teknikë vlerësimi e përdorur nga Banka për të identifikuar nëse për një instrument financiar ekziston një treg aktiv është ekzistenca e cmimeve të kuotuara për aktive dhe/ose detyrime të ngjashme, të cilat Banka mund t'i aksesojë në datën e raportimit. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve te mirinformuara të palidhura me njëra-tjetrën (nëse është e disponueshme), lidhur me vlerën e drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit bazohet maksimalisht te të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në llogaritjet specifike të Bankës, bashkon të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg konsiderojnë në vendosjen e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranuara për vendosjen e çmimit për instrumentat financiare. Të dhënat për teknikat e vlerësimit paraqesin pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë.

Banka kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg. Evidence më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose ripaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përftuar nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)
(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Aktivet dhe pozicionimet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionimet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Banka ka një pozicionim me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmime "mid-market" janë përdorur për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe një çmim i kërkuar ose ofertë rregullimi është aplikuar vetëm tek pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Bankës dhe të palës tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përftuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Politika kontabël e bankës lidhur me vlerësimin me vlerën e drejtë është diskutuar në Përmbledhje e Politikave të Rëndësishme Kontabël 2.4(IV). Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuara (te pakorrigjuara) të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuara në tregje aktivë për instrumenta identikë ose të ngjashëm, çmime të kuotuara për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuara për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare
Në çdo datë bilanci Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuara kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Banka me kusht që Banka nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

(i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar
Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni kundrejt huave dhe paradhënieve. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje
Për instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje, banka vlerëson në çdo datë të pasqyrave financiare nëse ka evidencë objektive që një investim është zhvlerësuar.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)
(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)
(ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje (vazhdim)

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar përmes një riklasifikimi, humbjen kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, në fitim ose humbe. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera, në fitim ose humbje, është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga çdo shlyerje principali dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionet për zhvlerësim që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Nëse në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje që është zhvlerësuar rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerret), dhe shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rritje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të zhvlerësuar të kapitalit njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(iii) Kreditë e rinegociuara
Kur është e mundur, banka kërkon të ristrukturojë kreditë në vend që të marrë në zotërim kolateralet. Kjo mund të përfshijë shtrirjen e afatit të pagesave dhe rënien dakord për kushte të reja të kredisë. Pasi kushtet janë rinegociuar, ndonjë zhvlerësim i mundshëm matet duke përdorur normën fillestare efektive të interesit, të llogaritur para modifikimit të termave dhe kredia nuk konsiderohet më me vonesë. Drejtimi vazhdimisht rishikon kreditë e rinegociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret janë përmbushur dhe se pagesat e ardhshme ka të ngjarë të ndodhin. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv nga zhvlerësimi, i llogaritur duke përdorur normën fillestare efektive të interesit të kredisë.

(6) Kompensimi i instrumentave financiarë
Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

(7) Matja me kosto të amortizuar e instrumentave financiarë
Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(8) Qiratë ("leasing")
Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Banka si një qiramarrës
Qiratë që nuk transferojnë te banka në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë ("leasing"). Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Banka si një qiradhënës
Qiratë ku banka transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e gjendjes financiare, Banka paraqet në pasqyrën e pozicionit financiar shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara. Të ardhurat nga shitja të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të leasing-ut janë vlera e drejtë e aktivit, ose, nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

(9) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve
Të ardhurat njihen në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret e mëposhtme specifike të njohjes gjithashtu duhet të plotësohen para se të ardhurat njihen.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)
(9) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve (vazhdim)

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit
Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.
Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

(ii) Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa
Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.
Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për tarifat dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

(10) Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to
Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

(11) Letrat me vlerë të investimit
Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(12) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja
Aktivet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese
Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që ne te ardhmen Banka do te këtë përfitime ekonomike nga këto pjese dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

(iii) Amortizimi
Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit përveçse për aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	% e amortizimit
Ndërtesa	5%
Pajisje elektronike	25%
Automjete	20%
Mobilie dhe pajisje zyre	20%
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	5%

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(13) Aktivet jomateriale

(i) Programe kompjuterike
Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimit njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(ii) Licencat
Licencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Banka janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim.

(14) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare
Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të bankës, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.
Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivit e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje anullohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anullohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(15) Garancitë Financiare
Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

(16) Përfitimet e punonjësve
(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme
Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar
Banka njeh si detyrim shumën e përllogaritur të kostos për lejet vjetore që pritët të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

(iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve
Banka gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)
(16) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

(iv) Kontribut vullnetar i pensionit për punonjësit
Banka ka krijuar një Plan Pensioni Profesional për punonjesit e vetë. Bank merr përsipër të paguajë kontribute për cdo punonjës që ka firmosur një kontratë individuale për "Planin Profesional të Pensionit." Shpenzimi vjetor përfaqëson kontributin vjetor të paguar nga Banka, dhe regjistrohet në zërin "Shpenzime Personeli," duke prekur pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të Bankës, dhe pa ndikuar në detyrimet e mëvonshme të Bankës, duke qënë se plani administrohet prej shoqërisë "Sicred SHA".

(17) Provizione për detyrime të kushtëzuara dhe angazhime
Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provizionuar.

Një provizion për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin te Banka nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me më të ultën mes vlerës aktuale të kostos së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit me kontratën. Para se të njihet provizioni, Banka njeh çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

(18)Tatimet
Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin
Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk tatohen apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

(ii) Tatimi i shtyrë mbi fitimin
Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Banka pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

(iii) Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin
Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht.

2.4 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(19) Prona të riposeduara
Politika e Bankes eshte te percaktoje nese nje aktiv i riposeduar do te perdoret per perdorim te brendshem nga Banka apo do te shitet. Aktivet e percaktuara si te dobishme per aktivitetet e brendshme te Bankes transferohen ne klasen perkatese te aktiveve me vleren me te ulet mes vleres se riposedimit dhe vleres kontabel te aktivit fillestar te siguruar.

Banka zoteron disa prona të riposeduara te cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave dhe paradhënieve ndaj klientëve. Banka i mat keto active te riposeduara fillimisht me kosto (çmim blerje). Ne fund te cdo periudhe raportuese keto aktive maten me me te voglen mes kostos dhe vleres neto te realizueshme. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çdo ndryshim në vlerën neto te realizueshme te pronave te riposeduara njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën lindin. Keto active çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga ky pakësim (nxjerrje jashtë përdorimit). Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja e pronës (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të aktivit) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

(20) Depozitat dhe borxhi i varur
Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur janë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një "marrëveshje riblerjeje" për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Banka zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuara (përfshirë të gjitha taksat dhe shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

(21) Dividendët
Dividendët e aksioneve të zakonshme janë njohur si një detyrim dhe janë zbritur nga kapitali në momentin kur ata janë miratuar nga aksionarët e bankës.

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 204, nuk ka patur dividend të deklaruar nga Banka per tu paguar aksionareve.

(22) Rezervat e kapitalit
Rezervat e regjistruara në kapital (të ardhurat e tjera përmbledhëse) në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

"Rezervën e përgjithshme" që përfshin ndryshimet e bëra për rezervën ligjore siç përcaktohet në Ligjin e Bankës Qendrore dhe Ligjin Tregtar të zbatueshëm në Shqipëri.

"Rezerva e rivlerësimit" e cila është përdorur për të regjistruar ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit.

3. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhurat nga interesat		
Hua dhe paradhënie për klientët	7,027,855	6,860,683
Letra me vlere te investimit	396,402	300,409
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	44,536	19,624
Hua dhënë bankave	151,387	185,269
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	100,779	115,220
Të ardhura nga interesat e përllogaritura mbi aktivet financiare të zhvlerësuara:		
Hua dhe paradhënie për klientët (të zhvlerësuar individualisht)	355,080	201,414
Hua dhe paradhënie për klientët (të zhvlerësuar në grup)	285,930	300,115
Totali i të ardhurave nga interesat	***8,361,969***	***7,982,734***
Shpenzimet për interesa		
Detyrime ndaj bankave	138,859	59,284
Detyrime ndaj klientëve	2,679,643	3,289,109
Borxhi i varur	291,459	240,636
Instrumenta financiare nga klientët	-	1,245
Totali i shpenzimeve për interesat	***3,109,961***	***3,590,274***
Të ardhurat neto nga interesat	**5,252,008**	**4,392,460**

4. Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Komisione nga shërbimet bankare	231,359	414,487
Tarifa dhe komisione nga shërbimet e huadhënies	207,454	23,572
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	***438,813***	***438,059***
Shpenzime për tarifa dhe komisione		
Tarifa për veprime ndërbankare	21,352	26,300
Veprime me thesarin	22,386	63,424
Të tjera	12,996	9,520
Totali i shpenzimeve për tarifa dhe komisione	***56,734***	***99,244***
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**382,079**	**338,815**

5. Të ardhura dhe shpenzime të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhura të tjera		
Të ardhura të tjera	12,508	18,234
Totali i të ardhurave të tjera	***12,508***	***18,234***
Shpenzime të tjera		
Shpenzime të tjera të lidhura me aktivitetet bankare	508,092	198,611
Shpenzime të tjera	31,750	2,326
Totali i shpenzimeve të tjera	***539,842***	***200,937***
Shpenzime te tjera, neto	**(527,334)**	**(182,703)**

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 përfshijnë shpenzime që lidhen me aktivitetet bankare, me rënien në vlerë të pronave te riposeduara, shpenzim i cili më 31 Dhjetor 2014 eshte në shumën 462,225 mijë Lekë (31 Dhjetor 2013: 192,179 mijë Lekë) (shënimi 17).

6. Shpenzime Personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Pagat e punonjësve	605,887	602,013
Sigurime shoqërore	76,316	71,600
Bonus dhe shpërblime	71,413	67,722
Sigurimet Shëndetësore	10,237	9,831
Të tjera	57,139	22,776
	820,992	**773,942**

7. Shpenzime Administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Sigurime dhe mbikëqyrje	361,184	309,283
Tarifa për palë të treta	300,705	165,307
Qira	249,643	238,637
Marketing dhe abonime	240,428	166,455
Rënie në vlerë të debitorëve	79,389	(3,893)
Mirëmbajtje	79,215	60,425
Ujë, energji	43,917	48,171
Pajisje	36,011	30,811
Transport dhe udhëtime	29,006	26,190
Provizione (referoju shënimit 24)	29,180	11,500
Të tjera	18,189	16,990
Taksa lokale dhe të tjera	14,206	27,521
	1,481,073	**1,097,397**

Tarifa për palë të treta është rritur gjatë vitit 2014 kryesisht për shkak të amortizimit të kontratës së konsulencës që ka afat 5-vjecar, për të cilën amortizimi vjetor ka qenë për 12 muaj të plotë, ndërkohë që për vitin 2013 amortizimi është llogaritur vetëm për 5 muaj. Gjithashtu ka patur rritje në numrin e kartave Visa Cards të lëshuara dhe numrit të transaksioneve të kryera nëpërmjet pikave të ATM-ve dhe POS-eve.

8. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Tatimi aktual	222,641	89,825
Tatimi mbi fitimin	**222,641**	**89,825**

Fondet për zhvlerësimet regjistruar si shpenzim nga banka në përputhje me SNRF do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme për efekt tatimi, me kusht që ato të jenë certifikuar nga një auditues i jashtëm dhe të mos tejkalojnë limitet e përcaktuara nga Banka Qendrore. Në përputhje me legjislacionin tatimor në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për 2014 eshte 15% dhe 2013 është 10%.
Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin është përmbledhur si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	607,783	363,004
Tatim fitim i llogaritur si 15% (2013: 10%) e fitimit kontabël	91,167	36,301
Shpenzime të pazbritshme	131,474	53,524
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	**222,641**	**89,825**

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritetet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen nga autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e panjohura përfshijnë humbje nga kreditë e pambledhshme, rënie vlere të pronave të riposeduara, provigjonet e krijuara, shpenzimin e amortizimit për përmiresimet e ambjenteve me qera të cilat nuk njihen per efekte fiskale, dhe shpenzime të tjera të panjohura sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

9. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogarite rrjedhëse me bankat	8,984,977	2,889,547
Vendosjet në tregun e parasë	6,267,971	11,448,662
Aktive monetare në arkë	3,005,720	4,225,663
Llogarite rrjedhëse të pakushtëzuara me Bankën Qendrore	896,990	494,679
Në tranzit	(624,640)	(143,067)
	18,531,018	**18,420,806**

Vendosjet në tregun e parasë përfshijnë vendosjet me bankat rezidente dhe jo-rezidente, me maturitet afatshkurtër, deri në 3 muaj. Mjetet monetare në tranzit përfaqësojnë pagesa ndaj Autoriteteve Tatimore të kryera nga klientë të Bankës, për të cilat Banka vepron si agjent për mbledhjen e tyre. Këto transaksione janë kryer brenda datës 31 dhjetor 2014, dhe mbyllen me transferimin e vlerave tek llogaria rrjedhëse e Bankës me Bankën Qëndrore në ditët e para të vitit 2015.

10. Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore lidhur me depozitën rezervë, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve pranë Bankës Qendrore si llogari rezervë. Rezerva ligjore nuk është e disponueshme për veprimtaritë e përditshme të Bankës. Maturiteti i rezervës ligjore krijohet çdo muaj dhe norma e interesit të aplikuar te rezerva e konvertuar në Lek është 70% i normës së repo-s një-javore (norma bazë) në Shqipëri, e cila më 31 Dhjetor 2014 ishte 2% (31 Dhjetor 2013: 3%). Rezerva e vendosur në monedha të tjera nuk gjeneron interes.

11. Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Bankat dhe institucionet e tjera financiare rezidente	637,842	415,758
Bankat dhe institucione e tjera financiare jo-rezidente	105,347	66,836
	743,189	**482,594**

12. Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Hua dhe paradhënie për klientët, me kosto të amortizuar	90,525,515	76,063,299
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	(10,721,143)	(8,723,593)
	79,804,372	**67,339,706**

Ndarja e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve sipas sektorit, janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Hua me hipotekë	57,259,622	46,375,401
Hua për individë	18,915,945	17,261,132
Hua për korporatat	4,138,685	4,164,639
Qira financiare	101,162	112,642
Hua të tjera të siguruara	10,110,100	8,149,485
	90,525,515	***76,063,299***
Fondi për humbje nga zhvlerësimi i huave	(10,721,143)	(8,723,593)
	79,804,372	**67,339,706**

Lëvizjet në fondin për humbje nga huatë janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Gjëndja më 01 Janar	8,723,593	6,487,122
Humbje nga zhvlerësimi i huave	2,452,440	2,271,591
Fshirje kredish	(617,056)	-
Efekti i kurseve të këmbimit	162,166	(35,120)
Gjëndja më 31 Dhjetor	**10,721,143**	**8,723,593**

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014, Banka konsideroi si të parikuperueshme dhe fshiu një shumë prej 135,113 mijë Lekë (2013: 253,589 mijë Lekë), e cila nuk ishte provigjonuar më parë.

Banka Credins SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

12. Hua dhe paradhënie klientëve (vazhdim)

31 dhjetor 2014 (në LEK '000)	Hua për korporatat	Hua per individët	Hua hipotekare	Qira financiare	Huadhënie te tjera te mbuluara	Total
Gjendja në 01 janar 2013	**4,314,740**	**364,446**	**1,783,380**	**9,508**	**15,048**	**6,487,122**
Humbje nga zhvlerësimi i huave	4,841,513	640,910	1,064,246	1,849	1,361,077	7,909,595
Rimarrje	(2,916,127)	(427,786)	(2,276,621)	(6,764)	(10,706)	(5,638,004)
Efekti i kurseve të këmbimit	(22,503)	(2,352)	(10,170)	(20)	(75)	(35,120)
Gjendja në 31 dhjetor 2013	**6,217,623**	**575,218**	**560,835**	**4,573**	**1,365,344**	**8,723,593**
Humbje nga zhvlerësimi i huave	4,554,248	142,574	312,714	1,933	717,876	5,729,345
Rimarrje	(2,442,300)	(162,745)	(198,059)	(1,475)	(472,327)	(3,276,906)
Fshirje kredish	(459,896)	(30,646)	(37,295)	(278)	(88,941)	(617,056)
Efekti i kurseve të këmbimit	120,865	8,054	9,801	73	23,374	162,167
Gjendja në 31 dhjetor 2014	**7,990,540**	**532,455**	**647,996**	**4,826**	**1,545,326**	**10,721,143**
						-
Më 31 dhjetor 2013						
Zhvlerësimet individuale	3,946,146	-	298,851	-	764,768	5,009,765
Zhvlerësimet në grup	2,271,477	575,218	261,984	4,573	600,576	3,713,828
	6,217,623	**575,218**	**560,835**	**4,573**	**1,365,344**	**8,723,593**
Më 31 dhjetor 2014						
Zhvlerësimet individuale	5,118,256	-	306,447	-	965,487	6,390,190
Zhvlerësimet në grup	2,872,284	532,455	341,549	4,826	579,839	4,330,953
	7,990,540	**532,455**	**647,996**	**4,826**	**1,545,326**	**10,721,143**
Shuma bruto e huave te percaktuara individualisht per zhvleresim, para zbritjes se provizionit individual te zhvleresimit	**10,180,843**	**-**	**732,923**	**-**	**2,037,599**	**12,951,365**

13. Letra me vlerë të vlefshme per shitje

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Bono thesari	13,247,652	5,452,826
Obligacione qeveritare	2,206,491	1,184,083
Totali	**15,454,143**	**6,636,909**

Bono Thesari

Normat efektive të interesit të bonove të thesarit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 variojnë midis 3.06% dhe 3.88% p.a. (2013: 3.39% dhe 6.54% në vit.). Detaje të bonove të thesarit më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013, lidhur me maturitetin e tyre fillestar, vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë në datën e raportimit, të klasifikuar sipas llojit janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2014					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
3 muaj	3,926,940	(30,396)	8,430	3,904,974	504	3,905,478
6 muaj	1,406,000	(21,033)	8,996	1,393,963	(168)	1,393,795
12 muaj	8,087,020	(258,560)	118,349	7,946,809	1,570	7,948,379
	13,419,960	**(309,989)**	**135,775**	**13,245,746**	**1,906**	**13,247,652**

	31 dhjetor 2013					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
3 muaj	1,100,000	(9,086)	1,728	1,092,642	(155)	1,092,487
6 muaj	1,927,080	(33,448)	8,824	1,902,456	(797)	1,901,659
12 muaj	2,516,392	(102,059)	40,859	2,455,192	3,488	2,458,680
	5,543,472	**(144,593)**	**51,411**	**5,450,290**	**2,536**	**5,452,826**

Obligacione qeveritare

Më 31 Dhjetor 2014, Banka kishte një portofol të obligacioneve qeveritare me afat 2-vjecar, 3-vjecar, 5-vjecar dhe 10-vjecar, të përkthyera në monedhën vendase (Lekë). Interesi është arkëtuar cdo 6-muaj me normë kuponi respektivisht 4.83% deri në 7.69% (2-vjecare), 5.78% deri ne 5.8% (3-vjecare), 4.99% deri ne 5.95% (5-vjecare) dhe 5.96% (10-vjecare). Detaje të obligacioneve qeveritare më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013, lidhur me maturitetin e tyre fillestar, vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë në datën e raportimit, të klasifikuar sipas llojit janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2014					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
24 muaj	1,400,000	-	10,846	1,410,846	(1,154)	1,409,692
36 muaj	200,000	-	2,766	202,766	1,837	204,603
60 muaj	483,176	-	8,123	491,299	1,645	492,944
120 muaj	100,000	2,187	1,060	103,247	(3,995)	99,252
	2,183,176	**2,187**	**22,795**	**2,208,158**	**(1,667)**	**2,206,491**

	31 dhjetor 2013					
	Vlera nominale	*Zbritja e shtyrë*	*Interesi i përllogaritur*	*Vlera e amortizuar*	*Diferenca e rivlerësimit*	*Vlera e drejtë*
24 muaj	450,000	-	5,502	455,502	3,360	458,862
36 muaj	200,000	-	8,801	208,801	(93)	208,708
60 muaj	383,176	-	10,446	393,622	20,795	414,417
120 muaj	100,000	2,435	682	103,117	(1,021)	102,096
	1,133,176	**2,435**	**25,431**	**1,161,042**	**23,041**	**1,184,083**

13. Letra me vlerë të vlefshme per shitje (vazhdim)

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në gjendjet e investimeve të vlefshme per shitje më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, përfshirë këtu shtesat, maturimet dhe shitjet e investimeve gjatë këtyre viteve:

	Lëvizjet në të vlefshmet për shitje	
	31 dhjetor 2014	**31 dhjetor 2013**
Gjendja me 01 janar	**6,636,909**	**4,699,608**
Riklasifikime	22,985,045	-
Shtesa	(300,000)	10,144,518
Shitje	(13,842,473)	(17,965)
Maturime	(25,338)	(8,194,787)
Luhatje në vlerën e drejtë	**15,454,143**	5,535
Gjendja me 31 dhjetor	**6,636,909**	**6,636,909**

Më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, Banka nuk zotëron letra me vlerë të mbajtura deri në maturim.

14. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Pajisje elektronike dhe zyre	Automjete, mobilie dhe pajisje të tjera	Investime në ambiente me qira	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 Janar 2013	**303,863**	**728,475**	**193,053**	**281,756**	**1,507,147**
Shtesat	-	53,157	1,309	2,075	56,541
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	(24,016)	(1,439)	-	(25,455)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**303,863**	**757,616**	**192,923**	**283,831**	**1,538,233**
Shtesat	-	83,058	5,910	2,781	91,749
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	(13,731)	(1,730)	-	(15,461)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**303,863**	**826,943**	**197,103**	**286,612**	**1,614,521**
Amortizimi					
Gjendja më 1 Janar 2013	**(110,095)**	**(431,319)**	**(93,985)**	**(138,672)**	**(774,071)**
Amortizimi i periudhës	(15,193)	(67,221)	(16,381)	(27,070)	(125,865)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	16,686	836	-	17,522
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**(125,288)**	**(481,854)**	**(109,530)**	**(165,742)**	**(882,414)**
Amortizimi i periudhës	(15,194)	(66,245)	(13,439)	(26,435)	(121,313)
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	9,207	722	-	9,929
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**(140,482)**	**(538,892)**	**(122,247)**	**(192,177)**	**(993,798)**
Vlera kontabël e mbartur					
Gjendja më 1 Janar 2013	**193,768**	**297,156**	**99,068**	**143,084**	**733,076**
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**178,575**	**275,762**	**83,393**	**118,089**	**655,819**
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**163,381**	**288,051**	**74,856**	**94,435**	**620,723**

15. Aktive jo-materiale

	Programe kompjuterike	Patenta dhe Licenca	Parapagime	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 Janar 2013	**114,193**	**68,490**	**3,678**	**186,361**
Shtesat	105,714	2,175	623	108,512
Nxjerrja jashtë përdorimi	(4)	(9,454)	(3,678)	(13,136)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**219,903**	**61,211**	**623**	**281,737**
Shtesat	9,871	313	-	10,184
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	-	(623)	(623)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**229,774**	**61,524**	**-**	**291,298**
Amortizimi				
Gjendja më 1 Janar 2013	**(77,364)**	**(15,010)**	**-**	**(92,374)**
Amortizimi i periudhës	(25,474)	(7,642)	-	**(33,116)**
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	6,712	-	**6,712**
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**(102,838)**	**(15,940)**	**-**	**(118,778)**
Amortizimi i periudhës	(33,586)	(7,656)	-	**(41,242)**
Nxjerrja jashtë përdorimi	-	-	-	**-**
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**(136,424)**	**(23,596)**	**-**	**(160,020)**
Vlera kontabël e mbartur				
Gjendja më 1 Janar 2013	**36,829**	**53,480**	**3,678**	**93,987**
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**117,065**	**45,271**	**623**	**162,959**
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**93,350**	**37,928**	**-**	**131,278**

16. Aktive tatimore të shtyra

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
	Aktive	**Detyrime**	**Neto**	**Aktive**	**Detyrime**	**Neto**
Letra me vlerë te vlefshme për shitje	967	-	967	-	(2,834)	(2,834)
Tatimi i shtyrë aktiv neto	**967**	**-**	**967**	**-**	**(2,834)**	**(2,834)**

Aktivi për tatimet e shtyra është regjistruar neto nga tatimi i shtyrë pasiv meqë shumat janë si rrjedhojë e të njëjtit autoritet tatimor dhe parashikohen të mbyllen. Më 31 Dhjetor 2014 dhe më 31 Dhjetor 2013, të gjitha aktivet ose pasivet e mësipërme për tatimet e shtyra njihen në pasqyrat financiare. Detyrimi apoaktivi i shtyrë tatimor buron nga rivlerësimi i instrumenteve të vlefshme për shitje, për të cilët luhatjet në vlerën e drejtë regjistrohen në rezervën e rivlerësimit në kapitalin neto.

17. Prona të riposeduara

Drejtimi i Bankës i klasifikon këto pasuri të marra nga ekzekutimi i kolateraleve të huave ndaj klientëve si prona te riposeduara. Vlera kontabël e tyre është vlera e drejtë e pasurisë përcaktuar sipas vlerësimeve nga vlerësuesi i pavarur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Gjendja më 1 Janar	**4,398,574**	**3,603,725**
Shtesa (shpenzime pasuese)	22,579	1,012,308
Nxjerrja jashtë përdorimi	(217,234)	(25,280)
Fitimi neto nga rregullimi i vlerës së drejtë	(462,225)	(192,179)
Gjendja më 31 Dhjetor	**3,741,694**	**4,398,574**

17. Prona të riposeduara (vazhdim)

Vlera e drejtë e pronave të riposeduara llogaritet duke u bazuar mbi vlerën e tregut, që nënkupton çmimin me të cilin mallrat dhe shërbimet e ngjashme të së njëjtës cilësi dhe sasi do të mund të shiteshin në një transaksion tregtar të paanshëm. Më 31 dhjetor 2014, pronat e riposeduara përfshijnë toka, ndërtesa dhe një makineri.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 Banka ka shitur rreth 217,235 mijë lekë aktive nga portofoli i pronave të riposeduara, prej të cilave Banka njohu rreth 37,959 mijë lekë si humbje nga shitja e tyre.

18. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Debitorë	208,687	248,151
Shpenzime të parapaguara	145,307	37,247
Shpenzime të shtyra	305,927	359,847
	659,921	**645,245**

Shpenzimet e shtyra përfaqësojnë një parapagim që Banka i ka bërë një kompanie këshilluese të jashtme gjate vitit 2014, per nje afat 5 vjecar. Më 31 dhjetor 2014 Banka ka bërë një parapagim prej 220 mijë EUR (30,830 mijë LEK), në vazhdim të parapagimit të bërë në 2013 për 2,780 mijë EUR (389,756 mijë LEK). Gjatë vitit 2014 shuma e njohur si shpenzim për vitin është 84,724 mijë LEK dhe është përfshirë në shpenzimet administrative si tarifa nga palët e treta (ju lutem referohuni shënimit shpjegues 7).

19. Detyrimet ndaj bankave

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogari rrjedhëse:		
Rezident	79,502	199,785
Depozitat e tregut të parasë:		
Rezident	466,775	1,031,079
Jo-rezident	1,286,586	-
	1,832,863	**1,230,864**

20. Huatë

Huatë deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 janë si të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermarrjes		
Ish-METE	165,767	222,029
EBRD	568,648	569,349
IFC	437,018	562,242
Instrumenta Financiarë detyrim ndaj individëve	-	363,505
	1,171,433	**1,717,125**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (ish-METE)

Gjatë vitit 2009 Banka siguroi një hua (të butë) nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si pjesë e "Programit për zhvillimin e sektorit privat shqiptar nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe asistencës teknike përkatëse" i Kooperimit Italo-Shqiptar për zhvillim (PRODAPS), i cili synon mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në Shqipëri duke lehtësuar aksesin e SME-ve vendase ndaj kredive. Norma e interest vjetor është 0.5% për hua në EURO, dhe 3.5% për hua në LEK.
Shlyerja ndaj METE-s bazohet në të njëjtat kushte të vendosura mbi shlyerjen ndaj përdoruesve përfundimtarë të kontratës së kredisë (huamarrës përfundimtarë).

Më 31 Dhjetor 2014 shuma e vlerësuar e huave është LEK 165,767 mijë (2013: LEK 222,029 mijë, dhe nuk ka patur detyrime të cilat nuk janë paguar në kohë për këtë hua të marrë, më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013.

20. Huatë (vazhdim)

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)

Më 7 mars 2013 Banka nënshkroi një marrëveshje kredie me Korporatën Financiare Ndërkombëtare ("IFC") në cilësinë e Entit Zbatues të Programit të Ndryshimeve Klimatike në Kanada ("CCCP"). Sipas kësaj marrëveshje kredie, IFC ra dakord t'i japë hua Bankës një shumë totale deri në 10 milion Euro, per energjinë e rinovueshme dhe investime qe lidhen me efikasitetin e energjise. Banka nuk ka vendosur kolateral per kete marreveshje kredie.

Më 31 Dhjetor 2014 shuma që i është disbursuar Bankës nga IFC në kuadër të kësaj marrëveshjeje kredie është Euro 3.1 milionë, ose LEK 436,002 mijë. Në kuadër të kushteve të kësaj marrëveshje kredie, Banka nuk ka lëshuar nën-kredi të reja gjatë vitit 2014 (2013: 164 nën-kredi në shumën 257,545 mijë lekë).

Për periudhën deri më 31 dhjetor 2014, Banka nuk ka qenë në përputhshmëri me 2 prej raporteve financiare të kërkuara nga IFC, që janë: Raporti i Ekspozimeve të Hapura të Kredive (OCER) dhe Raporti për Ekspozimin Ekonomik të Grupit (EGER). Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014, Banka nuk ka marrë nga IFC një letër pëlqimi apo heqje dore, dhe për rrjedhojë vlera e mbetur e huasë së marrë nga IFC deri më 31 dhjetor 2014 është trajtuar si afat-shkurtër (shënimi 28). Banka nuk ka patur detyrime të cilat nuk janë paguar në kohë për këtë hua të marrë, më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Në 28 Gusht 2013, Banka ka nënshkruar një marrëveshje huaje me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("BERZH"), në përputhje me Kuadrin Financiar të Ballkanit Perëndimor dhe Kroacise. Subjekt i kësaj marrëveshjeje huaje, BERZH ka rënë dakort t'i japë hua Bankës një shumë prej 8 milion Euro, me qëllim përdorimin e saj për të nxitur huadhënien per njesitë ekonomike të vogla dhe të mesme, ne rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacisë. Banka nuk ka vendosur kolateral per kete marreveshje kredie.

Më 31 Dhjetor 2014, shuma e disbursuar në Bankë nga EBRD sipas marrëveshjes së huasë është 4 milion Euro, ose 560,560 mijë Lek. Në përputhje me termat e kësaj marrëveshje huaje, Banka nuk ka lëshuar nën-kredi të reja gjatë vitit 2014 (2013: 39 nën-hua në shumën 230,036 mijë Lek.

Për periudhën deri më 31 dhjetor 2014, Banka nuk ka qenë në përputhshmëri me 1 prej raporteve financiare të kërkuara nga EBRD: Raporti i Ekspozimeve të Hapura të Kredive (OCER). Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014, Banka nuk ka marrë nga EBRD një letër pëlqimi apo heqje dore, dhe për rrjedhojë vlera e mbetur e huasë së marrë nga EBRD deri më 31 dhjetor 2014 është trajtuar si afat-shkurtër (shënimi 28). Banka nuk ka patur detyrime të cilat nuk janë paguar në kohë për këtë hua të marrë, më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013.

Instrumentat Financiarë nga individët

Gjatë muajit Dhjetor 2013, Banka aprovoi emetimin e instrumentave financiarë të tjera si borxh i varur nga individët. Individët e interesuar dhe të aprovuar ishin 23 (njëzet e tre) ndaj të cilëve u aprovua shuma prej 1.3 milion Euro dhe 180 milion Lek. Aprovimi është marrë nga Bordi i Mbikqyrjes Financiare më 31 Dhjetor 2014, për emetimin e këtyre instrumentave financiare. Këto instrumenta financiare janë njohur si borxhi i varur pas aprovimit përfundimtar të Bankës së Shqipërisë. Ky aprovim u mor më 3 Mars 2014 (data në të cilin këto pasqyra financiare janë riklasifikuar si borxh i varur në pasqyrat financiare të Bankës). Këto instrumenta financiare nuk janë të konvertueshëm në aksione të zakonshme. Më 31 dhjetor 2014, nuk ka instrumenta financiare nga individet të njohura në këto pasqyra financiare.

21. Detyrime ndaj klientëve

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Individë	90,698,723	78,455,358
Ente Qeveritare	9,819,055	5,141,351
Korporata	9,614,209	7,574,783
Klientë të tjerë	1,898,949	261,241
Llogari të aksionarëve	392,777	-
	112,423,713	**91,432,733**

Llogaritë e aksionarëve, përfaqësojnë vlerat e parapaguara nga disa prej aksionarëve të Bankës për shtesën e kapitalit të nënshkruar gjatë vitit 2014, dhe që deri më 31 dhjetor 2014 nuk është regjistruar ende në QKR.

21. Detyrime ndaj klientëve (vazhdim)

Detyrimet ndaj klientëve detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogari rrjedhëse		
Në monedhë vendase	12,793,671	7,363,508
Në monedhë të huaj	7,572,125	4,183,660
Llogari kursimi		
Në monedhë vendase	2,454,433	1,393,750
Në monedhë të huaj	2,271,546	1,901,344
Depozita me afat		
Në monedhë vendase	48,141,738	43,344,376
Në monedhë të huaj	38,145,878	32,434,688
Llogari të tjera klientesh		
Në monedhë vendase	800,425	135,634
Në monedhë të huaj	243,897	675,773
	112,423,713	**91,432,733**

Parapagimet e kryera nga aksionarët e Bankës për shtesën e kapitalit të nënshkruar gjatë vitit 2014, në vlerën 392,777 mijë Lekë janë paguar në monedhën Euro dhe përfshihen brenda zërit "llogari rrjedhëse në monedhë të huaj".

22. Borxhi i varur

Detyrimet e varura detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
SIFEM-AG (ish SECO)	582,073	582,550
Fondi Europian për Europën Juglindore	435,427	870,926
Instrumente të varura	3,126,896	1,633,866
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	**4,144,396**	**3,087,342**

Më 12 Dhjetor 2007 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi marrjen e borxhit të varur prej 2 milion Euro nga State Secretariat for Economic Affairs (SECO) i cili operon nëpërmjet Swiss Investment Fund for Emerging Markets (SIFEM). Me pas, me 31 Dhjetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi marrjen e nje borxhi tjeter te varur prej 2,120 mije Euro nga SIFEM. Keto borxhe do te paguhen me këste të barabarta prej 666,666 Euro dhe 706,666 Euro. Pagesa e 31 Dhjetorit 2014 ndaj SIFEM nuk u krye duke qene se Banka dhe SIFEM ishin ne negociata per perfundimin e amendimeve te kontrates se permendur me poshte. Me 10 Qershor 2014 Banka dhe SIFEM nenshkruan dy amendime te kontratave te permendura me siper, ku ripagimi i borxhit te varur u shty me 30 Qershor 2016, 31 Dhjetor 2016 dhe 30 Qershor 2017, me date efektive 31 Dhjetor 2014.

Me 8 shkurt 2008, Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve aprovoi marrjen e borxhit të varur prej 3 milion Euro nga European Fund for Southeast Europe (EFSE). Më 31 Korrik 2008, Banka mori një disbursim shtesë prej EUR 3 milion. Më 21 Mars 2014, Banka e Shqipërisë aprovoi shlyerjen e principalit të parë ndaj EFSE, për një vlerë prej EUR 3 milion. Më 15 janar 2015, Banka e Shqipërisë aprovoi shlyerjen e principalit të dytë ndaj EFSE, për një vlerë prej EUR 3 milion.

Më 31 Tetor 2011, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi emetimin e instrumenteve të varur në Lek, Euro dhe Dollar. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve aprovoi emetimin e 9te te instrumenteve të varur për individet për një vlere prej 4 milionë EUR, 479 milionë LEK dhe 480 mijë USD. Më 31 dhjetor 2014, nuk ka vlera të mbetura të papaguara në kohë.

Instrumentet janë detajuar më poshtë:

	Nr. i Instrumenteve	31 dhjetor 2014 '000 Lek	31 dhjetor 2013 '000 Lek
LEK	1,601	1,600,600	872,294
EUR	782	1,095,888	534,384
USD	374	430,408	227,188
	2,757	**3,126,896**	**1,633,866**

23. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera përbëhen nga:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Pagesa në transit	***6,319***	***5,736***
-Llogari pezull për transaksione në monedhë të huaj dhe zërat jashtë bilancit	226	350
-Financim publik	6,093	5,386
Furnitorë dhe shpenzime të përllogaritura	***143,884***	***158,056***
	150,203	**163,792**

24. Provizionet

Provizionet deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Provizione gjyqësore	13,275	11,883
Provizione tatimore	30,000	10,000
	43,275	**21,883**

Në tabelën e mëposhtme paraqiten lëvizjet në provizione gjatë 2014 dhe 2013:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
1 Janar	21,883	10,383
Kthime	(133)	-
Shtesa	21,525	11,500
Balanca më 31 Dhjetor	**43,275**	**21,883**

Në provizone përfshihet një shumë prej 10,383 mijë Lekë lidhur me gjobat tatimore nga kontrolli tatimor i 2008. Banka ka nisur një proces ligjor për këtë çështje, i cili nuk ka përfunduar ende deri më 31 dhjetor 2014, pasi vendimi është ende pezull nga Gjykata e Lartë.

Shtesat, përbëhen nga 20,000 mijë Lekë e krijuar prej disa detyrimeve të mundshme tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 (2013: 10,000 mijë Lekë).

Shuma tjetër e shtesave në Provizione, prej 1,525 mijë Lekë, është krijuar për një çështje gjyqësore në të cilën Banka është paditur nga një punonjës i vjetër i saj. Për këtë çështje po pritet vendimi i Gjykatës së Apelit të Vlorës.

Shuma e rimarrë prej 133 mijë Lekë lidhet me rastin gjyqësor në rrethin e Shkodrës në 2012 për të cilin gjykata ka vendosur në favor të Bankës.

25. Primi i kapitalit

Gjatë vitit 2014 Banka nuk ka emetuar kapital të ri, ndërsa në 2013 emetoi 6,301,526 aksione të reja, duke gjeneruar kështu një prim mbi aksionet prej 548,924 mijë Lekë.

26. Kapitali aksionar

Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të tipit A, dhe aksione të zakonshme të dyja me vlerë nominale prej 1 USD për çdo aksion. Kapitali i nënshkruar është në monedhat USD, EUR dhe LEK dhe raportohet në pasqyra financiare me kursin e këmbimit historik. Më 31 Dhjetor 2014 kapitali aksionar i nënshkruar është në shumat USD 14.390.490, EUR 13,474,422 dhe LEK 2,011,645,656. Aksionet janë të zakonshme dhe të tipit A dhe zotërohen nga aksionarët e mëposhtëm:

Kapitali aksioner	31 Dhjetor 2014 (%)	31 Dhjetor 2013 (%)
Renis Tershana	27.753%	27.753%
Aleksander Pilo	20.857%	21.857%
B.F.S.E Holding BV	19.249%	19.249%
Unioni Shqiptar Kursim Kredie	3.651%	3.651%
Drejtuesit e Përgjithshëm të Bankës	7.712%	12.266%
Te tjerë (aksionarë që zotërojnë më pak se 5% te aksioneve)	20.778%	15.224%
Totali	**100.000%**	**100.000%**

Kapitali i paguar i Bankës më 31 Dhjetor 2014 është Lek 5,438,330 mijë i kthyer me kursin historik të këmbimit (31 Dhjetor 2013: Lek 5,438,330 mijë) me një vlerë nominale 1 USD për aksion. Me 29 tetor 2014 Asamblea vendosi te emetoje capital te rine vleren prej 7.2 million EUR. Me 31 Dhjetor 2014 rreth gjysma e kapitalit eshte nenshkruar dhe paguar, por nuk eshte finalizuar rregjistrimi ne QKR.

Aksionet e Bankes kane vlere nominale dhe jane te pandashme. Çdo aksion i jep zoteruesit te tij te drejten e nje vote. Banka ka "aksione te zakonshme" dhe aksione te "klasit A", ku secili nga keto aksione ka nje vlere nominale prej 1 USD per aksion. Aksionet e "klases A" i japin zoteruesit te tij te drejta dhe privilegje te caktuara, kryesisht ne lidhje me transferimin e aksioneve, shitjen e aksioneve, konvertimin e aksioneve te "klases A" ne aksione te zakonshme, dhe te drejten per te propozuar emerimin dhe shkarkimin e 2 anetareve te Keshillit Drejtues. Mbajtesit e aksioneve te "klases A" te cilet veprojne se bashku permes perfaqesuesi te emeruar do te kene te drejtat dhe privilegjet e aksioneve te "klases A" persa i takon "para-aprovimit" te disa ndryshimeve dhe vendimeve dhe dis ate drejtave te informimit.

Te gjitha aksionet e mbajtura nga B.F.S.E Holding BV ose S.E.C.O. do te jene gjithnje aksione "A". Te gjithe aksionaret e tjere te Bankes mbajne aksione te zakonshme.

Një rakordim i kapitalit të paguar në fillim dhe në fund të periudhës është si më poshtë:

	Aksione të zakonshme		Aksione të tipit A	
	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Në fillim të vitit	**40,847,775**	**35,434,699**	**11,520,517**	**10,632,067**
Rritja në numrin e aksioneve	-	5,413,076	-	888,450
Me 31 dhjetor	**40,847,775**	**40,847,775**	**11,520,517**	**11,520,517**

27. Rezerva e përgjithshme

Banka ka krijuar dy rezerva duke përvetësuar fitimin e mbartur, të cilat paraqesin rezerva të përgjithshme, për aktivet me risk siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë dhe rezerva ligjore, siç kërkohet nga rregulloret e Bankës. Rezerva e përgjithshme është llogaritur si 1.25% e totalit të aktiveve të ponderuara me riskun ndërsa rezerva ligjore është llogaritur si 5% e fitimit vjetor. Këto rezerva nuk janë të vlefshme për tu shpërndarë.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Rezerva e përgjithshme	1,256,860	1,256,860
Rezerva ligjore	180,755	180,755
Totali	**1,437,615**	**1,437,615**

28. Analizë maturimi për aktivet dhe detyrimet

31/12/2014	< 12 muaj	> 12 muaj	Totali
Aktivet financiare			
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	18,531,018	-	**18,531,018**
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	9,372,093	946,866	**10,318,959**
Hua dhe paradhënie dhënë bankave	712,768	30,421	**743,189**
Letra me vlerë të investuara	13,704,143	1,750,000	**15,454,143**
Hua dhe paradhënie për klientët	37,153,694	37,153,694	42,650,678
Aktive afatgjata	-	620,723	**620,723**
Aktive jomateriale	-	131,278	**131,278**
Te drejta tatimore te shtyra	-	967	**967**
Prona te riposeduara	-	3,741,694	**3,741,694**
Aktive të tjera	351,191	308,730	**659,921**
Totali	**79,824,907**	**50,181,357**	**130,006,264**
Detyrimet financiare			
Detyrime ndaj bankave	1,807,354	25,509	**1,832,863**
Hua	1,014,656	156,777	1,171,433
Detyrime ndaj klientëve	101,639,546	10,784,167	**112,423,713**
Borxhi i varur	462,126	3,682,270	**4,144,396**
Detyrime tatimore korente	65,990	-	**65,990**
Detyrime të tjera	150,203	-	**150,203**
Provizione	43,275	-	**43,275**
Totali	**105,183,150**	**14,648,723**	**119,831,873**
Neto	**(25,358,243)**	**35,532,634**	**10,174,391**

31/12/2013	<12 muaj	>12 muaj	Totali
Aktivet financiare			
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	18,420,806	-	**18,420,806**
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	7,888,479	782,815	**8,671,294**
Hua dhe paradhënie dhënë bankave	473,903	8,691	**482,594**
Letra me vlerë të investuara	5,778,896	858,013	**6,636,909**
Hua dhe paradhënie për klientët	32,100,715	35,238,991	**67,339,706**
Aktive afatgjata	-	655,819	**655,819**
Aktive jomateriale	-	162,959	**162,959**
Te drejta tatimore korrente	53,453	-	**53,453**
Prona te riposeduara	-	4,398,574	**4,398,574**
Aktive të tjera	282,595	362,650	**645,245**
Totali	**64,998,847**	**42,468,512**	**107,467,359**
Detyrimet financiare			
Detyrime ndaj bankave	1,230,864	-	**1,230,864**
Hua	1,505,344	211,781	1,717,125
Detyrime ndaj klientëve	82,864,848	8,567,885	**91,432,733**
Borxhi i varur	52,620	3,034,722	**3,087,342**
Detyrime tatimore të shtyra	-	2.834	**2,834**
Detyrime të tjera	163,792	-	**163,792**
Provizione	21,883	-	**21,883**
Totali	**85,839,351**	**11,817,222**	**97,656,573**
Neto	**(20,840,504)**	**30,651,290**	**9,810,786**

29. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara

Në mënyrë që të përmbushë nevojat financiare të klientëve të saj, Banka hyn në angazhime të parevokueshme dhe detyrime të kushtëzuara. Ato konsistojnë nga garanci financiare, letra krediti dhe angazhime të tjera huadhënieje të padisbursuara. Edhe pse këto detyrime mund të mos njihen në pasqyrën e pozicionit financiar, ato mbartin rrezik krediti dhe rrjedhimisht edhe një pjesë të rrezikut të përgjithshëm të bankës. Letër-kreditë dhe garancitë (duke përfshirë letër-kreditë e pambyllura) e angazhojnë bankën që të kryejë pagesa për llogari të klientëve të saj nëse ndodh një ngjarje e caktuar, përgjithësisht e lidhur me importin dhe eksportin e mallrave. Garancitë dhe letër-kreditë mbartin një rrezik të ngjashëm krediti me kreditë. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara përfshijnë garancitë e dhëna klientëve dhe të marra nga institucionet e kreditit. Balancat janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Garanci dhe angazhime (Aktive)		
Garanci në favor të klientëve	3,276,062	3,962,067
Angazhime në favor të klientëve	11,095,915	2,721,747
Garanci dhe angazhime (Detyrime)		
Garanci të vendosura nga klientët kreditues	4,376,297	3,236,484
Garanci të marra nga klientë kreditues	319,407,396	220,648,600
Angazhime për letra me vlerë	478,831	641,986

Garancitë dhe letër kreditë
Garancitë e marra nga klientët përfshijnë kolateral monetar, hipotekar, inventarë dhe aktive të tjera me barrë siguruese të vendosura në favor të Bankës nga huamarrësi. Banka emeton garanci dhe letra krediti për klientët e saj. Këto instrumenta sjellin një risk kreditimi të ngjashëm me atë të kredive të dhëna. Në bazë të llogaritjeve të drejtimit, nuk ka asnjë humbje materiale në lidhje me garancitë dhe letrat e kreditit në 31 Dhjetor 2014.

Angazhime për qeratë operacionale – Banka si qiramarrës
Banka ka marrë me qera zyra në Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Lezhë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Shijak, Kavaje, Kukes, Berat, Ballsh, Mat, Peshkopi dhe Vorë në përgjithësi me afat nën 10 vjet. Këto angazhime të ardhshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Jo më vonë se 1 vit	240,370	232,441
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	652,692	744,747
Më vonë se 5 vjet	204,446	247,896
	1,097,508	**1,225,084**

Angazhime për qeratë – Banka si qiradhënës
Si pjesë të portofolit të "Huave dhe paradhënieve ndaj klientëve" Banka ka lëshuar qera financiare ndaj klientëve të vetë, në vlerën prej 93,130 mijë Lekë (31 Dhjetor 2013: 104,670 mijë Lekë). Këto qera financiare kanë një jetë mesatare që varion ndaj një deri në pesë vjet, pa patur klauzolë në kontratë për rinovimin e tyre. Pagesat minimale të qerave të pritshme për tu marrë (principal dhe interes) deri më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Jo më vonë se 1 vit	89,907	52,293
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	26,280	100,610
Total	**116,187**	**152,903**

Pretendime dhe çështje gjyqësore
Shoqëria është subjekt i pretendimeve dhe proçeseve gjyqësore të tjera të cilat konsiderohen të një natyre normale për aktivitetin e saj. Drejtimi i Bankës është i mendimit se kosto përfundimtare e zgjidhjes së këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt material në pozicionin financiar të Bankës, rezultatet e operacioneve apo në flukset monetare.

Çështje gjyqësore
Çështjet gjyqësore janë një ndodhi e zakontë në industrinë bankare për shkak të natyrës së aktivitetit që kryen banka. Banka ka kontrolle formale dhe politika për menaxhimin e këtyre çështjeve. Pasi merret këshilla profesionale dhe shuma e humbjes është përcaktuar, banka kryen korrigjimet e nevojshme për të marrë në konsideratë efektet e pafavorshme që këto çështje mund të kenë në pozicionin e saj financiar. Në fund të vitit, banka kishte disa çështje të pazgjidhura gjyqësore pa efekte të pafavorshme, rrjedhimisht, asnjë provizion tjetër përveç atij të përfshirë në shënimin 23, nuk është paraqitur në pasqyrat në pasqyrat financiare.

30. Shënime për palët e lidhura

Në tabelat e mëposhtme, Banka prezanton marrëdhëniet që ekzistojnë midis Bankës dhe palëve të lidhura me të, natyrën e transaksioneve, vlerat përkatëse, si dhe shpenzimet dhe të ardhurat deri më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013.

Drejtuesit e Bankës janë ata persona të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të Bankës, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, përfshirë këtu edhe drejtues ekzekutivë, ose jo, të lartë teë Bankës. Palët e tjera të lidhura të Bankës, që mund të jenë individë të lidhur me Bankën ose pjesëtarë të ngushtë të familjes së këtyre individëve, që kanë kontroll të plotë ose të përbashkët nga individët e lidhur me Bankën apo pjesëtarë të ngushtë të familjes së tyre, apo që kanë influencë të konsiderueshme mbi një entitet, prezantohen si Palë të tjera të lidhura të Bankës.

Transaksionet me palët e lidhura

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
Transaksionet	**Drejtuesit e Bankës**	**Palë të tjera të lidhura**	**Drejtuesit e Bankës**	**Palë të tjera të lidhura**
Shpenzime qiraje	-	-	-	24,381
Të ardhura	4,356	167,561	4,717	162,844
Shpenzime	73,380	30,858	83,617	67,388

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
Lloji i transaksionit	**Drejtuesit e Bankës**	**Palë të tjera të lidhura**	**Drejtuesit e Bankës**	**Palë të tjera të lidhura**
	Lek '000	**Lek '000**	**Lek '000**	**Lek '000**
Linjë kredie	-	1,220,385	-	960,500
Overdrafte	2,711	514,318	-	509,351
Karta Krediti	10,931	-	14,336	8,613
Hua me afat	215,836	275,347	23,604	388,731
Garanci/Inkaso	-	63,035	-	18,436
Llogari rrjedhëse	-	-	(21,120)	(147,392)
Depozita me afat	-	(417,448)	(56,484)	(419,946)
Borxhi i varur	-	-	-	-
Kolateral i vendosur në favor të bankës	(1,538)	(3,560,090)	(46,388)	(3,769,361)

	Norma e interesit (në %)	
	31 dhjetor 2014	**31 dhjetor 2013**
Linjë kredie	4.5%-11%	4.9%-11.81%
Overdrafte	4%-11%	4%-22%
Karta Krediti	2.31%-30%	14%-26%
Hua me afat	2.3%-18%	2.47%-18.5%
Llogari rrjedhëse	0.08%-0.2%	0.1%-0.2%
Depozita me afat	0.19%-5.5%	1.2%-6.9%

Për më tepër, pagat dhe shpërblimet për Drejtimin e Bankës ka qenë si më poshtë:

Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014	**Pagat**	**Bonuset**
Shpërblimi i drejtimit të Bankës	62,203	4,099
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	1,566	-
Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013		
Shpërblimi i drejtimit të Bankës	79,120	6,598
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	2,191	-

31. Ngjarjet pas datës së bilancit

Aksionarët e Bankës kanë rënë dakort që Banka Credins të blejë 76% të aksioneve që shoqëria "SiCRED SHA" zotëron tek "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit "SiCRED SHA,"" duke nënshkruar një Kontratë për Blerjen e Aksioneve më 22 dhjetor 2014. Aprovimi për ndryshimin e strukturës kontrolluese të shoqërisë "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit "SiCRED SHA"" është marrë nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 28 prill 2015. Ky ndryshim është regjistruar në regjistrin tregtar të shoqërisë në QKR më 10 qershor 2015, që është dhe data kur kalimi i kontrollit tek Banka Credins bëhet efektiv.

Drejtimi i Bankës nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së raportimit, që do të kërkonte axhustim ose dhënie informacionesh shtesë në pasqyrat financiare.

32. Administrimi i rrezikut financiar

32.1 Një vështrim i përgjithshëm

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- Rreziku i kreditimit
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Bankës të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut ne fushat e tyre specifike për të paravendosur limitet e ekspozimit.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrolle, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Banka, nëpërmjet
